



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Patos

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Mbi Auditimin Financiar të ushtruar në

Bashkinë Patos

Tiranë, shtator 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	8
II	HYRJA	8
1	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	9
2	Identifikimi i çështjes	9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	10
6	Standardet e auditimit	10
7	Metoda e auditimit	11
8	Dokumentimi i auditimit	11
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Patos	13
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	13
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm	13
2.2	Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore	24
2.3	Të tjera çështje përgjatë auditimit	45
IV	REKOMANDIME	59

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit në Bashkinë Patos.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 471/1 prot., datë 25.04.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi **Bashkinë Patos**, për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024. Për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve është në vlerën 782,338 mijë lekë ndërsa të ardhurat e veta janë në vlerën 285,445 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Patos për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- ✓ *Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm;*
- ✓ *Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;*
- ✓ *Të tjera çështje përgjatë auditimit;*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare. Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e

informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 15,647 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik; Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 8 gjetje dhe ka dhënë 8 rekomandime të cilat i përkasin kategorisë Masa Organizative.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,039,680 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 35,545,733 lekë me një rritje në vlerën 21,506,053 lekë. Me shkresën nr. 3590/2 prot., datë 03.12.2024, Drejtori i Drejtorisë së Financës ka paraqitur kërkesën për informacion lidhur me situatën debitore nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2024, drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore. Në vijim të korrespondencës të sipërcituar me shkresën nr. 766 prot., datë 07.03.2025, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit ka paraqitur situatën debitore progresive deri më datë 31.12.2024, për kategoritë “Biznes i madh dhe i vogël” në vlerën 5,129,068 lekë dhe “Subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarburet dhe derivatet e tyre” në vlerën 5,350,000 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, gjendja debitore progresive nga taksat dhe tarifatat vendore më datë 31.12.2024, sipas DZHETMT-së është në vlerën 232,775,650 lekë. Nga DZHETMT-ja nuk është paraqitur informacioni i plotë për kontabilizimin e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në Drejtorinë e Financës. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë të përfshirë debitorët kontratat për dhënien me qira të tokave bujqësore, abonentët familjarë, taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësishme vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.

- Në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.

- Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 3,146,559 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 1,074,287 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,146,559 lekë. Duek u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

- Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 13,981,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Patos me Nipt J63208406B është 14,530,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier me Nipt M23315402G. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Patos sipas Marrëveshjes “Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier”

me nr. 1808 prot., datë 26.07.2022, është 549,000 lekë ose në masën 5.49% (5.49% * 10,000,000 lekë / 100 = 549,000 lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 14,530,000 lekë.

- Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 782,365,081 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 304,182,116 dhe pakësime në vlerën 121,311,736 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 965,235,461 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie është përfshirë Kontrata e Punimeve me nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe OE “2.” Shpk me objekt “Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjellësit Qytetit Patos Loti 1 (Rrjeti shpërndarës)” dhe Kontrata e Mbikëqyrjes së Punimeve me nr. 2506/12 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe Shoqërisë “G.C.E” Shpk. Më datën 20.07.2022, është mbajtur Akt-kolaudimi i punimeve dhe më datë 29.07.2022, Çertifikata e Marrjes së Përkohshme në Dorëzim të Punimeve. Në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale”, vlera për kontratat e sipërpërmendura është kontabilizuar vlera 537,875,693 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

- Bashkia Patos, Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2025 të bëjë sistemimin e vlerës 1,074,287 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

- Nga Drejtoria e Financës të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

- Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 537,875,693 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të investimeve të përfunduara dhe të marra në dorëzim në llogarinë 231 “Për aktive afatgjata materiale”, duke i kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Patos, KLSH ka dhënë “*Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë*” për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:

a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Patos për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të

dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Patos janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të “modifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për paraqitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 15,647 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,039,680 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 35,545,733 lekë me një rritje në vlerën 21,506,053 lekë. Me shkresën nr. 3590/2 prot., datë 03.12.2024, Drejtori i Drejtorisë së Financës ka paraqitur kërkesën për informacion lidhur me situatën debitore nga takasat dhe tarifatat vendore për vitin 2024, drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore. Në vijim të korrespondencës të sipërcituar me shkresën nr. 766 prot., datë 07.03.2025, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit ka paraqitur situatën debitore progresive deri më datë 31.12.2024, për kategoritë “*Biznes i madh dhe i vogël*” në vlerën 5,129,068 lekë dhe “*Subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarburet dhe derivatet e tyre*” në vlerën 5,350,000 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, gjendja debitore progresive nga taksat dhe tarifatat vendore më datë 31.12.2024, sipas DZHETMT-së është në vlerën 232,775,650 lekë. Nga DZHETMT-ja nuk është paraqitur informacioni i plotë për kontabilizimin e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në Drejtorinë e Financës. Në gjendjen e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” nuk janë të përfshirë debitorët kontratat për dhënien me qira të tokave bujqësore, abonentët familjarë, taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.

Si dhe nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

- Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 3,146,559 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është është përlllogaritur

amortizim i akumuluar në vlerën 1,074,287 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,146,559 lekë.

- Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 13,981,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Patos me Nipt J63208406B është 14,530,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier me Nipt M23315402G. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Patos sipas Marrëveshjes “Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier” me nr. 1808 prot., datë 26.07.2022, është 549,000 lekë ose në masën 5.49% (5.49% * 10,000,000 lekë / 100 = 549,000 lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 14,530,000 lekë.

- Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 782,365,081 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 304,182,116 dhe pakësime në vlerën 121,311,736 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 965,235,461 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie është përfshirë Kontrata e Punimeve me nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe OE “2.” Shpk me objekt “Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetllës Qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)” dhe Kontrata e Mbikëqyrjes së Punimeve me nr. 2506/12 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe Shoqërisë “G.C.E.” Shpk. Më datën 20.07.2022, është mbajtur Akt-kolaudimi i punimeve dhe më datë 29.07.2022, Çertifikata e Marrjes së Përkohshme në Dorëzim të Punimeve. Në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale”, vlera për kontratat e sipërpërmendura është kontabilizuar vlera 537,875,693 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Patos në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 65,465,994 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 33 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Patos janë ngurtësuar fonde në vlerën 38,426,624 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Fier, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 38,426,624 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 471/1 prot., datë 25.04.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 28.04.2025, deri më 09.06.2025, në institucionin Bashkia Patos u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E.K. (Përgjegjës grupi)
2. M.H., anëtar
3. A.S., anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar

drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

2. Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi baza të risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Patos, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Patos.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për gatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tjera.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Patos në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të

respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Patos është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësi që varen prej tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave lokale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë” i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metoda e auditimit: Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në

fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampionëve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin¹:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve);

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.,.

- Verifikimi i transaksioneve është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

¹ ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimin e mbajtur, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Patos”:

Bashkia e re e Patosit kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkinë Mallakastër dhe në lindje me Bashkinë Roskovec. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Patosit. Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si “Patos-Marinza” është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur.

Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxyjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.

Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fasone. Për shkak të relievit malor, në këtë bashki ka zona të largëta me qendrën e bashkisë, popullsia e tyre është reduktuar ndjeshëm për shkak të zhvendosjes drejt qendrave urbane të vendit ose drejt vendeve fqinje. Bashkia Patos e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuar në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur. Bashkia Patos në veprimtarinë e tij drejtohet nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar riskun e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, eficiente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

1. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Nga auditimi u konstatua se, bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4,2,10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, rezulton se janë hartuar/miratuara: “Plan i Përgjithshëm Vendor” - [PPV] me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe “Rregullore e Planit Vendor”, të cilët hartohen si bashkëpunim i Bashkisë me KKT dhe miratuar me VKB Patos nr.48 datë 04.12.2020, me Vendim të KKT nr. 02 datë 28.12.2020; Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Zhvillimit Vendor - [SZHV], ku paraqiten synimet kryesore për një periudhë 5 vjeçare për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmerret për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse.,

BASHKIA PATOS	Njësitë Administrative
	Patos
	NJA Zharrëz
	NJA Ruzhdie

Punoi: Grupi i Auditimit

1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

a. Bashkia Patos ushtron funksionet e veta me Rregulloren e Brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative e të varësisë të Bashkisë Patos”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1/1 germa ‘b’, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] të çdo viti respektiv “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësive administrative si dhe nivelit të pagave” për vitin 2023 është VKB nr. 92 datë 22.12.2022 si dhe Vendimit të Kryetarit nr. 01 datë 04.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Patos”. Kjo Rregullore është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 21 datë 27.01.2023 e cila i përket Strukturës Organizative miratuar nga Kryetari i Bashkisë nr. 01 dt. 04.01.2023 i ndryshuar. Vendimet e

Këshillit Bashkiak janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Fier. Këto ndryshime nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme të njësisë.

b. Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar me Urdhër të Kryetarit nr.105 datë 24.05.2024 “Kodin e Etikës së Bashkisë Patos”, konform Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil;

c. Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike” me nr. 3480 prot., datë 24.12.2019, konformë Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.

“Kodi i Etikës” dhe “Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i Punës.

a. Punësimi në Bashkinë Patos bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pika 1,2.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Ligjore [DBNJL] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar ;

Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika (e,ë,f,g) të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Nga titullari i Bashkisë është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;

b. Struktura përgjegjëse e çdo bashkie harton në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18 dhe 69, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si edhe të atyre me Kontratë Pune konformë Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Patos”.

Nga verifikimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se për vitin 2024 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të bashkisë nr. 01 dt. 04.01.2024 “Mbi miratimin e strukturës, organikën, kategoritë, nivelin e pagave, klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së bashkisë dhe njësive shpenzuese në varësi të bashkisë Patos për vitin 2024”. Mbi këtë akt të miratuar është hartuar Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, i cili bazohet mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Ky informacion duhet të përcillet nga çdo njësi dhe përmban: pozicionin, përshkrimin e punës së çdo pozicioni, numrin e nevojshëm për punonjësve, kriteret e veçanta që duhet të plotësojë punonjësi sipas secilit pozicion etj., mbi të cilat klasifikohet edhe afati dhe koha e punës në kontratë.

Rezultoi se në fund të vitit 2023 nuk ka komunikim të dokumentuar mes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Njësive të tjera të strukturës së bashkisë, mbi informimin për nevojat e tyre për rekrutim për vitin pasardhës (2024), kjo pasi në strukturën organizative të miratuar, nuk është pasqyruar dhe numri i punonjësve që do të punësohen përkohësisht me afat 3 mujor. Kjo rezulton nga mungesa e informacionit të përgjithshëm mbi: numrin, kategorinë (specialistë apo punëtorë), baza ligjore mbi të cilën klasifikohet dhe grupi i pagës, drejtorinë/sektorin që iu nevojiten, përshkrimin e punës dhe arsyen e punësimit të tyre sezonal. Lista emërore e të punësuarve me kontratë 3 mujore.

Konstatim: Plani vjetor i punësimit rezulton të jetë hartuar dhe miratuar pa një studim të mirëfilltë nga secila strukturë e bashkisë mbi nevojat dhe kriteret e tyre, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 3, neni 9 pika 1.1/c.

Konstatim: Bashkia Patos ka hartuar "Planin Vjetor të Pranimin në Shërbimin Civil për vitin 2024" pa përfshirë edhe nevojat e njësive për ato pozicione marrëdhëniet e punës të të cilave me punonjësit rregullohen me Kodin e Punës, ka hartuar dhe miratuar strukturën organizative pa shoqëruar me një relacion të detajuar, mbi nevojat për punonjësit provizorë në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2015 "Për nëpunësin civil" neni 18; VKM nr. 108/2014 pika 11,13; si dhe udhëzimeve të DAP.


Konstatim: Bashkia Patos deri në 31.12.2023 ka publikuar vendet vakante në faqen zyrtare të saj si dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA, duke anashkaluar stendat e bashkisë, në moszbatim të VKM nr. 108/2014 "Për Planin vjetor të Pranimin në Shërbimin Civil" pika 13; VKM nr. 243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar Kreu II pika 6, 10/b.

c. Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret (e përgjithshme dhe të veçanta) që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit.*

Bashkia Patos funksionon me Rregullore të Brendshme të miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 25 datë 26.01.2024 e cila i përket Strukturës Organizative miratuar nga Kryetari i Bashkisë;

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Patos funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore". Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative shoqërohen edhe me Organigramën përkatëse për tu miratuar nga kryetari i Bashkisë.



Skemë e thjeshtuar e strukturës së NJVQV

A. Organi Përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak.

B. Organi Ekzekutiv i Bashkisë - Kryetari i Bashkisë.

Një pasqyrim i kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Patos me njësitë e varësisë për vitin 2024, për çdo njësi bazë të miratuara nga Kryetari i Bashkisë është në tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi i njësisë në Strukturën organizative Bashkia Patos	Nr. i punonjësve	
		V. I	V. II
1	Kabineti i Kryetarit	5	7
2	Sekretar i Përgjithshëm	1	1
3	NJAB	3	3
4	Drejtorja e Financës	6	11
5	Drejtorja e Shërbimit Social	6	
6	Drejtorja e të Ardhurave Vendore	5	5
7	Drejtorja e Hartimit të projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile	12	21
8	Drejtorja e Planifikimit urban, kadastrës, dhe kontrollit të zhvillimit urban	11	
9	IVMT		3
10	Drejtorja e zhvillimit Bujqësor, rural, pyjor, mjedisit dhe kontrollit ushqimor	18	17
11	Drejtorja e Burimeve njerëzore, legjislacionit dhe informimit publik	14	21
12	Drejtorja e Arsimit, Kulturës, Sportit	23	28
13	Drejtorja e integrimit evropian, koordinimit të fondeve të huaja dhe informimit publik	9	
14	Personeli edukativ, ndihmës parashkollor dhe para universitar	79	80
15	Policia Bashkiake	6	6
16	NJAB	3	3
17	NJ Prokurimeve Publike	3	3
18	NJA Ruzhdie	4	4
19	NJA Zharrëz	5	5
20	MZSH	14	14
		227	232
21	Gjendja Civile		
22	QKB		
23	ASHP	144	145
Totali		371	377

Burimi: Bashkia Patos/DJMBNJ

Konstatim: Në strukturën organizative për vitin 2024 nuk janë përfshirë funksionet e deleguara: Gjendja civile dhe QKB.

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitin 2023 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, pasqyrohet si më poshtë:

Niveli pozicionit	Aparati i Bashkisë Patos		Me njësitë e varësisë	
	Status i Nëpunësit Civil	Kodi i Punës	Status i Nëpunësit Civil	Kodi i Punës
Kategori e lartë	1	2	1	2
E mesme drejtuese	6	5	8	10
E ulët drejtuese	12	8	15	11
Ekzekutive	47	48	49	91
Totali	66	66	73	114
	132		377	

Burimi: Bashkia Patos/DJMBNJ

- Nga verifikimet e dokumentacionit dhe analiza e informacionit të pasqyruar, rezultoi se për funksionin “Mbrotjtja e Mjedisit” neni 26, në strukturën e Bashkisë Patos, ky funksion nuk mbulohet nga një njësi e veçantë, por në DZHBRPMKU²/Sektori i Pyjeve dhe mjedisit [SPM] është një specialist i mjedisit, që mbulon problemet mjedisore të territorit të bashkisë; Nga auditimi rezultoi se përgjegjësja e sektorit të pyjeve dhe mjedisit dhe specialistja për mjedisin kanë hartuar planet e aktiviteteve për vitin 2024 sipas ditëve mjedisore të përzgjedhura.

2. Menaxhimi i Riskut

2.1 Regjistri i Riskut Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t’i vihet në dispozicion Regjistri i .riskut, i cili pasqyron identifikimin e risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se Bashkia Patos për vitin 2024 ka hartuar Regjistrin e riskut dhe miratuar me nr. 3444 prot., datë 12.09.2024.

Konstatim: Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut të unifikuar, por nuk kanë identifikuar risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga burime të jashtme, në moszbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Regjistri i Riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* “Planifikimin dhe Përdorimin me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave”. Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollat ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë. Në regjistrin e riskut nuk ka përshkruar marrjen e një pakete masash që të përfshijë jo vetëm njësitë e strukturës së Bashkisë, por edhe Njësitë Administrative dhe ASHP.

Bashkia Patos ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik* [GMS] me Urdhrin nr. 20 datë 05.02.2024 dhe me nr. 71 prot., datë 13.08.2024.

2.2 Strategjia e riskut, përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Patos për vitin 2024 ka hartuar Strategjinë e riskut dhe e ka miratuar nga Kryetari i bashkisë me nr. 2550 prot., datë 29.09.2023, konform kjo Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/a; neni 21, pika 2,3; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kapitulli II pika 2.2.5; 2.2.7;

» Lidhur me *Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT*, grupi i auditimit referuar informacionit të dhënë nga specialisti IT si dhe verifikimeve në “Deklaratën, Raportin dhe Formularin e Vetëvlerësimit” që dërgohen çdo fillim viti në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për vitin ushtrimor 2024, rezultoi se Bashkia Patos për të gjitha shërbimet

² Drejtoria e Zhvillimit bujqësor, Rural, Pyjor, Mjedisit dhe Kontrollit të ushqimit

që u ofron qytetarëve, si edhe të gjitha Bashkitë e tjera, operojnë në sisteme kombëtare online dhe që administrohen në zbatim të VKM nr. 673/2017 nga AKSHI;

Nga specialisti IT çdo vit paraqiten në Drejtorinë e Financës kërkesat buxhetore mbi nevojat institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjet IT.

Nga auditimi **rezulton** se nuk tregohet vëmendja e duhur për mirëmbajtjen e mirëfunksionimin e Programit të financave vendoren Tais -Fais, si aset i rëndësishëm i bashkisë që ndikon në rritjen e performancës së aktivitetit të bashkisë në përgjithësi dhe Drejtorisë së të ardhurave vendore në veçanti.

Në mesin e Bashkisë janë instaluar kamera, investim ky i bërë nga fondet e Bashkisë, të cilat menaxhohen nga specialisti IT; Ka dhomë serverësh, e cila rezultoi sipas parametrave të “Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverave” hartuar nga AKSHI/2008;

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT **u konstatua:** **1.** Nuk ka rregullore për përdoruesit e tjerë të këtyre sistemeve, ku të përcaktohet dhe ndarja e detyrave, siguria në komunikim. **2.** Nuk kryhet Backup i databazës dhe konfigurimeve të pajisjeve IT; mungesë dokumentacioni mbi procedurat e veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave të tyre etj. ku mundësohet gjurma e auditimit të aktivitetit dhe efica e tyre. **3.** Sistemet mbështeten nga 1 (një) specialist IT i vetëm, i pozicionuar në DBNJL³/SBNJ. **4.** Nga ana e Burimeve njerëzore për vitin 2022 mungon analiza mbi nevojat vjetore për trajnim, nuk është hartuar plan vjetor për trajnim të specialistit IT në veçanti dhe nuk janë hartuar plane/programe për të gjithë përdoruesit e sistemeve, gjë që cenon sigurinë e informacionit. Për sa më lart, në moszbatim të VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”. Udhëzimit nr.115 dt.17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit; Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9 pika 4/dh; “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kapitulli III pika 3.1.

b. Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës. Nga auditimi rezultojnë se proceset e punës janë hartuar nga sektorë të veçantë dhe për disa nga proceset e punës, konkretisht: nga njësia e prokurimit me vlerë të vogël dhe miratuar nga titullari i bashkisë me nr. 2244 prot., datë 16.09.2022; “rregullore mbi procedurën e ndjekjes së zhvillimit të projekteve /punimeve të investimeve publike” miratuar me nr. 941 prot., datë 11.04.2022; “Procedura standarde e veprimit për matjen e volumit të punës dhe normën e harxhimit të karburantit të ekskavatorit në Bashkinë Patos” miratuar me nr. 3352 prot., datë 31.12.2021; “Procedura standarde e veprimit për furnizimin me karburant të mjeteve të ASHP” miratuar me nr. 1575 prot., datë 22.06.2022; “Procedura standarde e veprimit mbi furnizimin me karburant të ekskavatorit të Bordit të kullimit dhe skrepit” miratuar me nr. 1577 prot., datë 22.06.2022”.

Konstatim: Bashkia Patos deri më sot nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës të unifikuar, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3 dhe sipas Aneksit 2, Aneksit 3;

³ Drejtoria e burimeve njerëzore dhe Legjislacionit

3. Veprimtaritë e Kontrollit. Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj. Për këtë, çdo Njësi Publike dhe NJVQV duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Kontrollit të Brendshëm (periodik apo vjetor), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen; gjithashtu ndihmon në monitorimin e detyrave që menaxherët e njësisë i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

Konstatim: Nga Bashkia Patos, nga të gjitha njësitë e strukturës *nuk është hartuar/miratuara një Plan i Kontrollit të Brendshëm* i unifikuar, periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kapitulli III pika 3.3.

- Lloji i Kontrollit që zbatohet në Bashkinë e Patosit është ai parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit:
 - a. Kontrolle në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit
 - b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ)
 - c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i 2 firmave)
 - d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.
 - e. Ka rregullore për Sistemet IT të cilat *nuk iu janë vënë* në dispozicion çdo përdoruesi;
 - f. Parashikuar procedura te qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor e elektronik
 - g. komunikimi dhe trajtimi urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësave individuale të çdo pozicioni.
 - h. Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, ka një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës të përshkruara në “Rregulloren e funksionimit e sekretari – arkivit” miratuar me Vendim të Kryetares nr.635 datë 05.03.2019.
 - i. Bashkia Patos ka hartuar dhe ka miratuar nga Titullari në cilësinë edhe të NA, Rregullore “Për menaxhimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të Bashkisë Patos” me nr. 885/2 prot., datë 26.09.2013, e nënshkruar nga grupi i punës prej 5 (pesë) anëtarësh.
 - j.1** Bashkia Patos me Vendimin e Kryetarit nr. 162 datë 14.01.2022, ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesit, ka hartuar Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit” me nr.251/3 prot. Datë 04.03.2019, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, neni 13 pika 10;
 - 2.** Ka hartuar Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, me nr. 251/2 prot. Datë 04.03.2019 në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” neni 19 pika 8.
- Për periudhën nën auditimi grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI⁴ me nr. 81 prot., datë 10.01.2024 për vitin 2023 i cili rezulton pa raste sinjalizimi të

⁴ Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; Deri më 31.12.2023 në bashkinë Patos nuk ka patur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit.

4. Informacioni dhe Komunikimi. Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe kanë kryer trajnime të pjesshme mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” të organizuar nga ASPA. Kjo ka bërë që në mënyrë të vazhdueshme të ruhet komunikimi ndërmjet njësive brenda strukturës së Bashkisë si dhe Bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj. Informacioni shkëmbehet në nivel horizontal dhe vertikal. Bashkia e Patosit disponon një Rregullore të Brendshme ku rezultoi se nuk janë përshkruar edhe ndryshimet e bëra në Strukturë dhe Organikë gjatë vitit 2023 sipas VKB-ve përkatëse. Në Bashkinë e Patosit është emëruar *Koordinatori për Informim* dhe *Koordinatori i Transparencës* konform Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 15, 16. Çdo informacion dhe njoftim publikohen në WEB-in e Bashkisë. Mos përditësimi i Rregullores së Brendshme me ndryshimet e strukturës organizative të miratuara, mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit (të unifikuara), riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre brenda njësië publike (bashkisë) dhe bashkisë me njësitë e varësisë.

a. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë)

b. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Patos.

c. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në Institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit.

d. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA).

e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë verbale, shkresore të protokolluar dhe më rrallë elektronike.

5. Monitorimi. Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë edhe të Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut, merr raporte katër mujore nga drejtuesit e programeve buxhetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve, si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet Ministrisë së Financave si dhe prezantohet edhe në Këshillin Bashkiak.

Ky raportim bëhet në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 65 të Ligjit nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” e të UMFE nr. 22/2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Raportet e monitorimit janë dërguar në MFE: për 4 mujorin I me nr. 1187/10 prot., datë 30.05.2024; për 8 mujorin me nr. 2423/2 prot., datë 29.09.2024 si dhe Raporti vjetor i monitorimit për 12 mujorin me nr. 674 Prot., datë 28.12.2024. Këto Raporte Monitorimi përmbajnë: Pyetësonin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funkcionimin e

Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK që për vitin 2023 janë dërguar në MFE me shkresën nr. 3311/1 prot., datë 05.02.2024, me shkresën nr. 3311/2 prot., datë 05.02.2024 dhe me shkresën nr. 3311/3 prot., datë 05.02.2024. Gjithashtu nga ana e Bashkisë Patos, “Drejtoria e zhvillimit bujqësor, blegtoral, pyjor, mjedisit dhe kontrollit të ushqimit” ku përfshihet edhe sektori që mbulon mbrojtjen e mjedisit dhe ASHP, raportojnë çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Ministria e Turizmit dhe Mjedisin) dhe te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të Ligjit nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr.10463/2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.

Vlerësimi dhe aktiviteti i Auditit të brendshëm në sektorin publik:

1.2 Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NjAB në Sektorin Publik”.

a. NjAB është e organizuar në nivel *sektori*, në përbërjen e të cilës janë pozicionuar 4 auditues të brendshëm në strukturën e Bashkisë Patos (1 përgjegjës + 3 auditues), konform kërkesave të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, rëndësia e të cilës konsiston në faktin se “Njësia e Auditimit të Brendshëm” ka funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Patos, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

b. Nga NjAB Bashkia Patos janë dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm: Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm 2024-2026 me nr. 2507/3 prot., datë 10.10.2023; Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm 2024-2026 me nr. 2507/2 prot., datë 10.10.2023;

Plani strategjik i auditimit në njësitë e sektorit publik/NJVQV, mbështetet në programet dhe objektivat e NjQV-së (bashkisë dhe ndërmarrjeve të varësisë) ku ushtron veprimtarinë audituese, si dhe në *identifikimin dhe vlerësimin e risqeve* që ndikojnë në (mos) realizimin e objektivave të këtyre njësive. NjAB mbi bazën e njohjes dhe të studimit të objektivave strategjike dhe të risqeve të njësisë publike, evidenton jo vetëm subjektet dhe fushat e auditimit që do të realizohen në programin strategjik afatmesëm (PSA), por edhe frekuencën e realizimit të këtyre auditimeve. Planifikimi i auditimit bëhet duke patur parasysh anën funksionale e organizative të subjekteve që janë objekt auditimi, raportet vjetore të institucionit, raportet e mëparshme të auditimit të brendshëm, rekomandimet e auditimit të jashtëm (KLSH), regjistrat e riskut dhe këshillat/opinionet e drejtuesve të njësive respektive në strukturë.

Nga NjAB janë hartuar raportet vjetore të aktivitetit të saj ose dokumentet e sigurimit të cilësisë dhe regjistri i riskut për vitin 2024 miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 204/1 prot., datë 13.02.2024, të cilat janë dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm brenda afatit të përcaktuar në Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik miratuar me Urdhrin e MFE nr. 100/2016, datë 25.10.2016.

c. Përbërja e strukturës së NjAB në Bashkinë Patos nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024 miratuar me VKB nr. 83 prot datë 27.11.2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NjAB	Përgjegjës	Specialist Auditues	Kualifikimi profesional	Emëruar	Numri i punonjësve Plan/Fakt
Viti 2024	1	4		Me pa ertifkatë	4/4
E.H.			Financë	Po/2023	x

R.V.			Financë	Jo	x
R.B.		x	Ekonomiks	Jo /	x
Xh.Gj.		x	Ekonomi & Politika Agrare	Jo	x

Burimi: Bashkia Patos/ NjAB

Nga verifikimi i strukturës organizative dhe tabela përmbledhëse rezulton se NjAB e Bashkisë Patos është krijuar dhe miratuar me VKB në rang sektori me 4 auditues (1 + 3) dhe vazhdon të funksionojë me po këtë strukturë, konform Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Mbi miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” pika 3.

d. Trajnimet e NjAB dhe certifikimet:

Referuar Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK-së, miratuar me Urdhrin e MFE nr. 108/2016, Ligjit nr. 114/2015, “Mbi Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, nga Bashkia Patos është hartuar një plan vjetor trajnimesh për audituesit e NjAB-së, referuar planit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me Urdhrin nr. 248 datë 31.12.2021;

Trajnimi i audituesve të NJAB-së duhet të përmbushi planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo auditues të certifikuar, përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Kjo për mirëfunksionimin e auditimit të brendshëm në njësinë publike, për të cilën gjatë procedurës audituese, duhet të mbështetet në zbatimin me korrektësi të 7 (shtatë) parimeve të përgjithshme.

Për sa është trajtuar në akt konstatim nr. 2, nga Bashkia Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1187/7 prot., datë 16.06.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 471/3 prot., datë 19.06.2025, nga znj. J. Sh. Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: I. Në lidhje me konstatimet tuaj për pikën 1.2/a:

1. Plani vjetor i punësimit rezulton të jetë hartuar dhe miratuar pa një studim të mirëfilltë nga secila strukturë e bashkisë mbi nevojat dhe kriteret e tyre

2. Bashkia Patos ka hartuar “Planin vjetor të pranimit të shërbimit Civil për vitin 2023 pa përfshirë edhe nevojat e njësisë për ato pozicione marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohem me Kodin e Punës”.

Ju sqarojmë se Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Informimit Publik ka hartuar dhe miratuar Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil për Bashkinë Patos për vitin 2024 me shkresën me nr. 628 prot., datë 29.02.2024. Ky plan është hartuar në përputhje me stukturën e miratuar me VKB nr. 74, datë 30.10.2023, dhe pozicionet vakante në Bashkinë Patos. Gjithashtu me shkresën nr. 664 prot., datë 05.03.2024, është miratuar Plani Vjetor i pranimit në pozicionet me Kod Pune në Bashkinë Patos për vitin 2024 në përputhje me VKB nr. 74, datë 30.11.2023, dhe nevojat e secilit Sektor/Drejtori.

II. Në lidhje me konstatimin tuaj për pikën 1.3 ju sqarojmë se: Gjendja Civile dhe QKB nuk ka qenë asnjëherë pjesë përbërëse e strukturës organizative të Bashkisë Patos pasi janë funksione me varësi të dyfishtë dhe emërimi i tyre nuk kryhet nga Bashkia Patos.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Në lidhje me konstatimin e kryer nga ana e grupit të auditimit si dhe pas shqyrtimit të observacionit nga ana e Subjektit, ritheksojmë që në studim përfshihen shumë faktorë të ndryshëm si dhe objektiva të institucionit, të cilat gjatë analizimit të planit vjetor të punësimeve nuk u vunë re të ishin marrë për bazë.

Në lidhje me Gjendjen civile dhe QKB, observacioni merret në konsideratë dhe do të kryhen rregullimet përkatëse përgjatë materialit.

Observacioni pranohet pjesërisht.

2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.2.1. Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar:

- Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre;
- Inventarizimi periodik;

2.2.2. Auditim i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme;
- Llogarive të pagueshme;

2.2.3. Auditim i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat;
- Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Patos për vitin ushtrimor 2024 janë të nënshkruara nga z. F.D. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. M.Sh. Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Fier me shkresën nr. 951 prot., datë 28.03.2025, dhe konfirmuar nga DTH Fier në mënyrë elektronike më datë 02.04.2025, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumatat për çdo llogari dhe në total mujor e

vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur

këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Patos për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024**. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024:

Bashkia Patos 2024, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Paga (600)	168,367	0.70	9
Sigurime Shoqërore (601)	28,447	0.70	2
Mallra e Shërbime (602)	72,144	0.70	4
Investime të brendshme (230-231)	304,351	2.00	48
Të tjera transferime korrente (606)	209,029	0.70	12
Total	782,338		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	15,647		
Kalkulimi i precizionit	0		
Materialiteti	15,647		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,565		
Nëntotali	14,082		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	12,674		
Bashkia Patos 2024, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për t'u shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	0	0.70	0
Të ardhurat e veta	285,445	0.70	43
Total	285,445		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	5,709		
Kalkulimi i precizionit	0		
Materialiteti	5,709		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	571		
Nëntotali	5,138		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	4,624		

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat

për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,.

Për realizimin e procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të institucionit për vitin 2024 ka dalë Urdhri nr. 266, datë 01.11.2024, i Kryetarit të Bashkisë z. F.D., ku janë ngritur komisionet e inventarizimit, konkretisht:

a. Aparati, Sporti, Stacioni i MZSH-së, Magazina e Bashkisë, Mjetet e Transportit, Makinerive, Pajisjeve e Veglave të Punës, Biblioteka, Pallati i Kulturës, QKF, Klubi i Pensionistëve, Ish-Zyrat e Bashkisë, Qendrës Multifunkionale, Tregart dhe NjA Zharrë dhe Ruzhdie, nga grupi i punës me përbërje: znj. D.N. z. A.G., z. A.K.; znj. F.Gj. dhe znj. B.L..

b. Çerdhja e Bashkisë Patos, Shkollat, Kopshtet e NjA Patos, Zharrës dhe Ruzhdie, nga grupi i punës me përbërje: z. E.A, znj. F.X., z. D.Sh., znj. L.Q. dhe znj. B.D..

c. Aktivet e Qëndrueshme, Asetet që janë në kontabilitetin e Bashkisë Patos si dhe të atyre që janë vetëm në regjistrin e pronave si ndërtesa, rrugë, troje, toka, projekte, prona të tjera sipas regjistrit të pronave, nga grupi i punës me përbërje: znj. B.M., znj. K.K., znj. V.S., z. A.G., z. E. K, z. A.Sh.a dhe z. O. D..

Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisionet e sipërpërmendura është hartuar Raporti për Inventarin Fizik me shkresën nr. 4003/1 prot., datë 15.01.2025, dhe nr. 4003/2 prot., datë 15.01.2025, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit është dorëzuar Nëpunësit Zbatues.

Me shkresën nr. 4003/3 prot., datë 20.01.2025, znj. M.Sh. Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është drejtuar Kryetarit të Bashkisë me një Relacion shoqërues për inventarizimin dhe vlerësimin të materialeve të inventarit të Bashkisë Patos së bashku me Njësitë Administrative.

Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 51, datë 17.02.2025, me objekt “Për nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve të inventarit 2024”, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të vlerësuara si të tilla nga komisioni për secilin grup, inventari që është jashtë funksionit të përdorimit në vlerën 1,855,906.52 lekë sipas llogarive si më poshtë:

- Llogaria 327/1 “Inventar i imët” në vlerën 1,043,430.52 lekë;

- Llogaria 218/1 “Inventar informatik” në vlerën 21,288 lekë;

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 736,308 lekë;

- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 54,880 lekë;

Me shkresën nr. 522 prot., datë 17.02.2025, z. F.D. Kryetar i Bashkisë është drejtuar Këshillit Bashkiak Patos me informacion mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të vitit 2024. Deri më datë 09.06.2025, nga Bashkia Patos nuk është realizuar procesi i asgjesimit të aktiveve sipas Vendimit nr. 51, datë 17.02.2025.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Patos, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

	Lekë
Aktivitet Neto janë të barabarta me Aktivitet - Pasive = Aktivitet Neto	2,048,719,031
Aktivitet	2,179,907,423
Pasivitet	131,188,391
Aktivitet Neto	2,048,719,031

		Lekë
Aktivët Afatshkurtra më datë 31.12.2024		439,751,593
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”		344,285,542
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”		29,743,654
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”		65,722,397

A. AKTIVET

I. Aktivët Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	344,285,542	277,567,766	66,717,776
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		344,285,542	277,567,766	66,717,776

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 277,567,766 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 344,285,542 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 278,819,548 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 65,465,994 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 49-50.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
31	Materiale	3,577,182	2,626,410	950,772
32	Inventar i imët	26,166,472	24,787,852	1,378,620
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		29,743,654	27,414,262	2,329,392

- Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 29,743,654 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 3,577,182 lekë dhe 32 “Inventar i imët” 26,166,472 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,329,392 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 2,329,392 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 31 “Materiale”**, ka vlerën 3,577,182 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë		
Lëvizjet e llogarisë	Vlera	
Çelje e vitit 2024	2,626,410	
Shtesa (K)	26,491,948	
Pakësime (D)	25,541,176	

Gjendja në 31.12.2024	3,577,182
-----------------------	-----------

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 26,166,472 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2024		24,787,852
Shtesa (K)		7,826,297
Pakësime (D)		6,447,677
Gjendja në 31.12.2024		26,166,472

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023	Lekë
	Llogari të arkëtueshme				
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0	
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0	
431	Tatime e taksa	0	0	0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0	
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0	
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0	
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0	
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0	
44	Institucione të tjera publike	0	0	0	
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0	
468	Debitorë të ndryshëm	35,545,733	14,039,680	21,506,053	
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	30,176,664	16,037,012	14,139,652	
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0	
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0	
	Totali	65,722,397	30,076,692	35,645,705	
	Të tjera aktive afatshkurtra				
409	Parapagime	0	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënive me thesarin	0	0	0	
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0	
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0	
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0	
	Totali	0	0	0	

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,039,680 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 35,545,733 lekë me një rritje në vlerën 21,506,053 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 1.**) në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2024		14,039,680
Shtesa (K)		307,871,876
Pakësime (D)		286,365,822
Gjendja debitore në 31.12.2024		35,545,733

Me shkresën nr. 3590/2 prot., datë 03.12.2024, znj. M.Sh. Drejtor i Drejtorisë së Financës ka paraqitur kërkesën për informacion lidhur me situatën debitore nga takasat dhe tarifave vendore për vitin 2024, drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore. Në vijim të korrespondencës të sipërcituar me shkresën nr. 766 prot., datë 07.03.2025, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit ka paraqitur situatën debitore progresive deri më datë 31.12.2024, për kategoritë “Biznes i madh dhe i vogël” në vlerën 5,129,068 lekë dhe “Subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarburet dhe derivatet e tyre” në vlerën 5,350,000 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, gjendja debitore progresive nga taksat dhe tarifave vendore më datë 31.12.2024, sipas DZHETMT-së është në vlerën **232,775,650 lekë**. Në mënyrë të përmbledhur paraqiten të dhënat si më poshtë:

Lekë

Nr.	Përmbledhësja e Debitorëve	Gjendja 31.12.2024
1	Biznesi i madh + i vogël	5,129,068
2	Debitorë nga kontratat për dhënie me qira të tokave bujqësore	2,294,254
3	Subjektet që tregtojnë hidrokarburet dhe derivatet e tyre	5,350,000
4	Abonentët familjarë	105,221,422
5	Taksa e tokës bujqësore	76,278,275
6	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	38,502,631
	Totali	232,775,650

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

Për sa trajtuar më sipër evidentohet se, nga DZHETMT-ja nuk është paraqitur informacioni i plotë për kontabilizimin e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në Drejtorinë e Financës. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë të përfshirë debitorët kontratat për dhënie me qira të tokave bujqësore, abonentët familjarë, taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

Për sa është trajtuar në akt konstatim nr. 1, nga Bashkia Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1187/6 prot., datë 16.06.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 471/2 prot., datë 19.06.2025, nga z. C.R. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Referuar materialit tuaj Aktkonstatimi nr. 1, datë 09.06.2025, pika A. Aktivet ndarja I. Aktivet Afatshkurtra, pika 3 “Llogari të Arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” faqja 10, nga ana juaj është trajtuar llogaria 468 në mënyrë analitike me të gjithë debitorët e Bashkisë Patos duke përfshirë debitorët për taksat dhe tarifatat vendore. Për sa më sipër DZHETMT me shkresën nr. 766 prot., datë 07.03.2025, ka përcjellë situatën debitorëve për kategorinë “Biznesi i madh dhe i vogël” në vlerën 5,129,068 lekë, subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarburet dhe derivatet e tyre në vlerën 5,350,000 lekë dhe subjektet debitorëve të kontratave të tokave bujqësore në vlerën 2,294,254 lekë, e cila nuk është përmendur në aktin tuaj. Lidhur me evidentimin e debitorëve të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet të cilat çertifikohen nëpërmjet procesit të legalizimit të objekteve pa leje, ky informacion kalon në Bashkinë Patos nëpërmjet ASHK, informacion ky i cili është përcjellë pranë nesh për herë të fundit më datë 17.05.2023. Pas kësaj date nuk ka më informacion nga ana e ASHK lidhur me ecurinë e aplikimeve nga individë të tjerë. Edhe pse nga ana jonë me shkresën nr. 1867 prot., datë 11.07.2024, është kërkuar informacion për individ të cilët kanë aplikuar për këtë proces ende nuk ka një përgjigje nga ana e ASHK. Në këto kushte vlera e debisë për këtë taksë ka ngelur e pa ndryshuar, por kjo kategori është e evidentuar në mënyrë analitike (të bashkëlidhet shkresa me emërtimet). Lidhur me taksapaguesit familjarë DZHETMT i ka të evidentuar të gjitha familjet sipas rregjistrave të gjendjes civile të Bashkisë Patos, gjithashtu dhe sipërfaqet e tokave bujqësore të banorëve të cilët kanë përfituar tokë bujqësore sipas Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, janë të evidentuar sipas formularëve 6 të ndarjes së tokave bujqësore, sipërfaqe e cila taksohet nga ana jonë në bazë të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Problematika e konstatuar nga grupi i auditimit nuk ka të bëjë me mënyrë si DZHETMT mban me ASHK-në Fier korrespondencën si Agjent Tatimor në lidhje me arkëtimin e detyrimeve nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, por me vlerën e kontabilizuar në pasqyrat financiare. Konkretisht nga DZHETMT nuk është përcjellë informacioni i plotë Drejtorisë së Financës për sa i përket debitorëve që vijnë si pasojë e mos likuidimit të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Patos. Për më tepër sipas mbylljes progresive të situatës debitorëve nga kjo drejtori debitorët më datë 31.12.2024, janë në vlerën 232,775,650 lekë, që do të thotë se nuk janë të përfshirë të gjitha kategoritë e debitorëve duke sjell edhe nënvlerësimin e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

- Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 16,037,012 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 30,176,664 lekë me një rritje në vlerën 14,139,652 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”		Lekë
Çelje e vitit 2024		16,037,012
Shtesa (K)		30,176,664
Pakësime (D)		16,037,012
Gjendja debitore në 31.12.2024		30,176,664

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 17,866,277 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 7,378,247 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 809,426 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 2,327,744 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 315,926 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerë 1,479,044 lekë ku totali shkon në vlerën 30,176,664 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 30,176,664 lekë në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	II. Aktive Afatgjata	1,740,155,829	1,550,869,874	189,285,955
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	761,864	641,801	120,063
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	761,864	641,801	120,063
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	759,628,504	753,332,992	6,295,512
210	Toka, Troje, Terene	3,146,559	3,146,559	0
211	Pyje, Plantacione	0	0	0
212	Ndërtesa e konstruksione	574,248,193	583,529,013	(9,280,820)
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	98,188,407	103,356,220	(5,167,813)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	22,161,948	8,726,593	13,435,355
215	Mjete transporti	28,208,201	17,982,751	10,225,450
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	32,225,196	35,141,857	(2,916,661)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	1,450,000	1,450,000	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	14,530,000	14,530,000	0
25	Huadhënie e nën-huadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	14,530,000	14,530,000	0
	4. Investime	965,235,461	782,365,081	182,870,380
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	965,235,461	782,365,081	182,870,380

1. Aktivët Afatgjata Jomateriale.

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 641,801 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 168,962 lekë dhe amortizim të akumuluar

në vlerën 697,641 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 761,864 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 2.**) në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,290,545
	2	Amortizim i akumuluar	648,744
	3	Gjendja në 01.01.2024	641,801
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	168,960
	5	Amortizim i shtesës	48,897
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,459,505
	5	Amortizim i akumuluar	697,641
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	761,864

2. Aktivitet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 3,146,559 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 1,074,287 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,146,559 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 3.**) në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	4,220,846
	2	Amortizim i akumuluar	1,074,287
	3	Gjendja në 01.01.2024	3,146,559
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	4,220,846
	5	Amortizim i akumuluar	1,074,287
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	3,146,559

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” konstatohet se, për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” është përlllogaritur normë amortizimi të akumuluar në vlerën 1,074,287 lekë. Bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30, citohet se: “Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përgjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për grososje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme”. Në kushte të tilla për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 838,795 lekë dhe pakësime në vlerën 838,795 lekë (që i përket transferimit në Agjencinë e Shërbimeve Publike), ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari	
	1	Kosto historike	0

Ditari i veprimeve	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2024	0
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	838,795
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	838,795
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	0
	5	Amortizim i akumuluar	0
6	Gjendja më datë 31.12.2024	0	

Lekë				
Pyje, kullota, plantacione (kosto historike)	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Objekte inventari				
Fidal eukolipsi dhe predha për pyllëzim	0	838,795	838,795	0
Totali	0	838,795	838,795	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

- **Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 583,529,014 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur pakësime në vlerën 19,895,630 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 254,094,770 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 574,248,193 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 4.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	808,447,333
	2	Amortizim i akumuluar	224,918,318
	3	Gjendja në 01.01.2024	583,529,014
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	19,895,630
	5	Amortizim i shtesës	29,176,451
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	828,342,963
	5	Amortizim i akumuluar	254,094,770
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	574,248,193

- **Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 103,356,218 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur pakësim në vlerë 78,227,104 lekë, pakësime në vlerën 78,227,104 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 36,036,587 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 98,188,407 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 5.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	134,224,994
	2	Amortizim i akumuluar	30,868,776
	3	Gjendja në 01.01.2024	103,356,218
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	78,227,104
	5	Amortizim i shtesës	5,167,811
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	78,227,104
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	134,224,994
	5	Amortizim i akumuluar	36,036,587
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	98,188,407

- **Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 8,726,593 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 13,815,520 lekë, pakësime në vlerën 54,880 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 4,435,505 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 22,161,948 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 6.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	12,836,813
	2	Amortizim i akumuluar	4,110,220
	3	Gjendja në 01.01.2024	8,726,593
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	13,815,520
	5	Amortizim i shtesës	380,165
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	54,880
	7	Amortizim nga pakësimet	54,880
	4	Kosto historike	26,597,453
	5	Amortizim i akumuluar	4,435,505
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	22,161,948

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 17,982,751 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,886,550 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 18,033,799 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 28,208,201 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 7.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 "Mjete transporti"	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	32,130,000
	2	Amortizim i akumuluar	14,147,249
	3	Gjendja në 01.01.2024	17,982,751
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	14,112,000
	5	Amortizim i shtesës	3,886,550
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	46,242,000
	5	Amortizim i akumuluar	18,033,799
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	28,208,201

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 35,141,857 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 6,626,708 lekë, pakësime në vlerën 757,596 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 57,049,409 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 32,225,196 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 8.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 "Inventar ekonomik"	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	83,405,493
	2	Amortizim i akumuluar	48,263,636
	3	Gjendja në 01.01.2024	35,141,857
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	6,626,708
	5	Amortizim i shtesës	9,543,369
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	757,596
	7	Amortizim nga pakësimet	757,596
	4	Kosto historike	89,274,605
	5	Amortizim i akumuluar	57,049,409
	6	Gjendja më datë 31.12.2024	32,225,196

- **Llogaria 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 1,450,000 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,450,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogarinë 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara"	
Çelje e vitit 2024	1,450,000
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0

Gjendja debitore në 31.12.2024	1,450,000
--------------------------------	-----------

Në këtë llogari është përfshirë automjeti tip Benz me targë A.V me vlerë kosto historike 1,450,000 lekë i cili nuk është në gjendje pune i dëmtuar dhe është nxjerrë jashtë përdorimit sipas Vendimit nr. 27, datë 13.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”.

Nga auditimi konstatohet se, asetet e kaluara nga Pushteti Qendror pranë Bashkisë Patos paraqitet sipas VKM-ve si më poshtë:

- **Bashkisë Patos** me VKM nr. 443, datë 15.06.2016, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Patos, të Qarkut Fier”, janë transferuar në total 300 prona. Nga totali i pronave të transferuara janë çertifikuar 11 prej tyre në Njësinë Administrative Patos.

- **Ish-Komunës Rruzhdie, sot Njësia Administrative Rruzhdie** me VKM nr. 432, datë 15.05.2013, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Zharëz, të Qarkut Fier”, janë transferuar në total 178 prona. Nga totali i pronave të transferuara janë çertifikuar 7 prej tyre në Njësinë Administrative Zharrës.

- **Ish-Komunës Zharrëz sot Njësia Administrative Zharrëz** me VKM nr. 558, datë 27.07.2016, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësia Administrative Zharrëz”, janë transferuar në total 865 prona. Nga totali i pronave të transferuara janë çertifikuar 2 prej tyre në Njësinë Administrative Rruzhdie.

- Me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, janë transferuar në total 27 pasuri.

Referuar listave të miratuara të inventareve si më lart, Bashkia Patos zotëron **në total 1,370 prona.**

Deri më datë 31.12.2024, në total janë pajisur me çertifikatë pronësie 20 prona dhe 5 prona janë proces çertifikimi, për të cilat të dhënat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. i pasurisë	Data e rregjistrimit	ZK	Çertifikatë	Sipërfaqe truall m ²	Sipërfaqe ndërtimi m ²	Pasqyruar ose jo në bilancin e bashkisë
1	Qendra Shëndetësore, Zharrëz	117/2	28.02.2020	3922	1989463	567	128.6	Po
2	Shkolla e mesme, Zharrëz	116/1	27.01.2017	3922	641083	4305	654.5	Po
3	Ish-zyrat e N.F.P lagjia “1 Maj” (ish-instituti)	Jun-15	28.06.2021	2890	2890031055	504	413	Po
4	Ish-kapanon + fjetore	1/340	02.11.2020	2890	1456523	300	265	
5	Qendra shëndetësore, Rruzhdie	802/11	29.01.2021	3250	3250005045	260	90	Po
6	Shkolla “Zhani Çiko”	Jan-13	01.09.2020	2890	1989464	4703	1010	Po
7	Shkolla “Mustafa Matohiti”	22/683	01.09.2020	2890	1989469	2060	828	Po
8	Ish-ndërmarrja e gazit, Dukas	3561	02.09.2020	1567	1989466	6110	786	
9	Ish-Qendra e kualifikimit (banesa sociale)	8/205	15.06.2020	2890	1975662	549	462	po
10	Ambulanca, Lënginas	1250	02.09.2020	2411	1989467	96	20	
11	Ambulanca, Dukas	3461	29.01.2021	1567	1567014228	216	92	po
12	Magazina nr. 2, Patos	7/445	02.11.2020	2890	1456523	260	250	Po
13	Çerdhe, lagjia e re	10/429	07.10.2020	2890	1989751	320	264	Po
14	Pylli, Belinë	02-Jan	14.02.2019	1142	1895716	15000		
15	Pylli, Belinë	02-Mar	14.02.2019	1142	1895718	15000		
16	Pylli, Belinë	02-May	14.02.2019	1142	1895720	5000		
17	Pylli, Belinë	02-Aug	14.02.2019	1142	1895721	5000		
18	Truall, Zharrëz	117/10	01.09.2020	3922	1989463	567	128.6	
19	Ish-këndi sportiv, lagjia “Naftëtari”	7/227	04.09.2024	2890	2890030209	4598		
20	Shkolla “Muhamet Shehu”, lagjia “Naftëtari	7/245	09.08.2024	2890	Dërguar në ASHK	3336	820	Po
21	Kopshti nr. 1, lagjia “1 Maj”	5/317	18.09.2024	2890	Dërguar në ASHK	1692	555	Po
22	Ish-furrë buke, lagjia “29 Marsi”	15/478	29.05.2024	2890	Dërguar në ASHK	2920	658	jo
23	Kopshti, Sheqishte	104/2	30.10.2024	3361	Dërguar në ASHK	656.7	186.2	Po
24	Ish-shkolla 9-vjeçare, Kuqar	1/209	25.01.2024	2329	Dërguar në ASHK	1785	426	Po

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. i pasurisë	Data e rregjistrimit	ZK	Çertifikatë	Sipërfaqe trualli m ²	Sipërfaqe ndërtimi m ²	Pasqyruar ose jo në bilancin e bashkisë
25	Kopshti Dukas-Breg	2326	19.09.2024	2890	Dërguar në ASHK	100	72.3	Po
26	Shkolla 9-vjeçare Drenie	424/A	10.12.2024	1537	Dërguar në ASHK	2250	330	Po

- Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Patos të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 20 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Patos nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërmat “a-b”, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

- Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 13,981,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Patos me Nipt J63208406B është 14,530,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier me Nipt M23315402G. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Patos sipas Marrëveshjes “Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier” me nr. 1808 prot., datë 26.07.2022, është 549,000 lekë ose në masën 5.49% (5.49% * 10,000,000 lekë / 100 = 549,000 lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 14,530,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Për sa është trajtuar në akt konstatim nr. 1, nga Bashkia Patos është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1187/8 prot., datë 16.06.2025, administruar në KLSH me praktikën nr. 471/4 prot., datë 19.06.2025, nga znj. M.Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Është konstatuar se llogaria 26 është e mbivlerësuar në vlerën 13,981,000 lekë sqarojmë se: Drejtoria e Financës së Bashkisë Patos ka kontabilizuar në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” sipas rekomandimeve të KLSH, vlerën 14,530,000 lekë sipas regjistrimit tregtar të subjektit “Ndërmarrja e Ujësjetllës Patos”, ku Bashkia ka qenë 100% aksionare. Me Marrëveshjen nr. 1808 prot., datë 26.07.2022, “Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier”, vlera e aksioneve për Bashkinë Patos është 5.49% ose 549,000 lekë. Nga Drejtoria e Financës së bashkisë nuk është bërë sistemimi i vlerës së aksioneve, pasi nuk ka një vendim të Këshillit Mbikëqyrës për sa kohë ky subjekt është me statusin “në proces likuidimi”, e vërtetuar me QKB në datë 16.06.2025.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit: Pretendimi që paraqitet nga ana Juaj është një problematikë e hasur edhe në auditimin e institucioneve të tjera të vetëqeverisjes vendore, në lidhje me transferimin e kapitalit

nga ujësjellsat lokal në atë rajonal, ku evidentohet që shumë prej tyre janë për likuidim. Funksionimi dhe organizimi i tyre është kryer nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse në të cilat evidentohet edhe përqindja e aksioneve që disponin secila bashki. Në këtë kontekst edhe kontabilizimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” duhet të kryehet sipas kësaj marrëveshje, pra vlera e kapitalit që disponon bashkia në Ujësjiellësin Rajonal. Në rast se do të ketë përditësime të vlerës së kapitalit me anë të një procesi rivlerësimi të aseteve nga Shoqëria Rajonale edhe përditësimi i saj duhet të kryer mbi bazën e rivlerësimit. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Invenstimet

- Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 782,365,081 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 304,182,116 dhe pakësime në vlerën 121,311,736 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 965,235,461 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 9.) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Gjendje në 01.01.2024	782,365,081
Shtesa (K)	304,182,116
Pakësime (D)	121,311,736
Gjendja në 31.12.2024	965,235,461

Në përbërje të kësaj llogarie është përfshirë Kontrata e Punimeve me nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe OE “2.” Shpk me objekt “Rikonstruksion i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjiellësit Qytetit Patos Loti 1 (Rrjeti shpërndarës)” dhe Kontrata e Mbikëqyrjes së Punimeve me nr. 2506/12 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe Shoqërisë “G.E. Shpk. Më datën 20.07.2022, është mbajtur Akt-kolaudimi i punimeve dhe më datë 29.07.2022, Çertifikata e Marrjes së Përkohshme në Dorëzim të Punimeve. Në gjendjen e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale”, vlera për kontratat e sipërpërmendura është kontabilizuar vlera 537,875,693 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, Klasa 23.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 965,235,461 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 965,235,461 lekë e cila kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 965,235,461 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, gërma “c”.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Patos më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	17,866,277	1,190,709	16,675,568
42	Detyrime ndaj personelit	7,378,247	9,916,560	(2,538,313)
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	809,426	681,017	128,409
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	2,327,744	3,193,482	(865,738)
436	Sigurime shëndetësore	315,926	434,356	(118,430)
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	65,465,994	53,133,380	12,332,614
467	Kreditorë të ndryshëm	1,479,044	620,888	858,156
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	35,545,733	14,039,680	21,506,053
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		131,188,391	83,210,072	47,978,319

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** më datë 01.01.2024, është në vlerën 1,190,709 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Patos. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 461,014,431 lekë lekë dhe pakësime në vlerën 444,338,863 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 17,866,277 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2024	1,190,709
Shtesa (K)	461,014,431
Pakësime (D)	444,338,863
Gjendja debitore në 31.12.2024	17,866,277

Lekë

Nr.	Subjekti	Emërtimi i mallrave	Vlera
1	A.S.	Pajisje zyre për Administratën dhe informatike	1,452,000
2	S.	Ndërtim mure mbajtëse në qytet dhe rrethina	283,817
2	Sh.	Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i Palestrës	16,055,285
4	GCE	Mbikqyrës Ujësjetllësi Loti 2	75,175
Totali			17,866,277

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 7,378,247 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2024	9,916,560
Shtesa (K)	136,489,110
Pakësime (D)	139,027,423
Gjendja debitore në 31.12.2024	7,378,247

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	14.01.2025	6,654,449
2	14.01.2025	419,435
3	14.01.2025	207,687
4	14.01.2025	96,679
Totali		7,378,247

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 809,426 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Çelje e vitit 2024	681,017
Shtesa (K)	10,605,152
Pakësime (D)	10,476,743
Gjendja debitore në 31.12.2024	809,426

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
5	15.01.2025	809,426
Totali		809,426

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhet në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 2,327,744 lekë dhe 315,926 lekë.

Lekë

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”	
Çelje e vitit 2024	3,193,482
Shtesa (K)	41,732,394
Pakësime (D)	42,598,132
Gjendja debitore në 31.12.2024	2,327,744

Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”	
Çelje e vitit 2024	434,356
Shtesa (K)	5,581,534
Pakësime (D)	5,699,964
Gjendja debitore në 31.12.2024	315,926

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
5	15.01.2025	2,643,670
Totali		2,643,670

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Patos në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 65,465,994 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Fier. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 10.) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2024	53,133,380
Shtesa (K)	12,657,614
Pakësime (D)	325,000
Gjendja debitore në 31.12.2024	65,465,994

- Për 33 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Patos janë ngurtësuar fonde në vlerën 38,426,624 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Fier, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 38,426,624 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2024, janë në vlerën 620,888 lekë. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 258,288,566 lekë dhe pakësime në vlerën 257,430,410 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,479,044 lekë. Lëvizja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2024	620,888
Shtesa (K)	258,288,566
Pakësime (D)	257,430,410
Gjendja kreditore në 31.12.2024	1,479,044

Lekë

Nr.	Subjekti	Emërtimi i investimit	Fatura		
			Nr.	Data	Vlera
1	ibc	Interneti dhjetor 2024	28/2025	06.01.2025	32,727
2	IO	Shërbim printimi dhjetor 2024	417/2025	10.01.2025	158,866
3	P.Sh.	Posta dhjetor 2024	83/87	10.01.2025	39,545
4	P.Sh.	Shërbime postare tarifë invaliditeti	1013/2025	10.01.2025	147,248
5	Bashkia Patos	Këshilltarët dhjetor 2024	S'ka	Dhjetor 2024	723,350
6	Bashkia Patos	Dëmshpërblimet familjeve Zharrëz nga Bankers	S'ka	Dhjetor 2024	377,308
Totali					1,479,044

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

- **Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime) më datë 01.01.2024**, është në vlerën 14,039,680 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 25,641,390 lekë dhe pakësime në vlerën 4,135,337 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 35,545,733 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”	
Çelje e vitit 2023	14,039,680
Shtesa (K)	25,641,390
Pakësime (D)	4,135,337
Gjendja debitore në 31.12.2023	35,545,733

Lekë

Operacione me shtetin (detyrime)	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Debitorët nga taksat dhe tarifat vendore	14,039,680	4,135,337	25,641,390	35,545,733
Totali	14,039,680	4,135,337	25,641,390	35,545,733

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos.

- Nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Por si kundërparti në bilanc pasqyrohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 7.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	2,048,719,031	1,802,718,522
D	FONDI I KONSOLIDUAR	2,048,719,031	1,802,718,522
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	790,134,022	781,389,056
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	278,819,548	224,434,385
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	965,235,461	782,365,081

106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	14,530,000	14,530,000
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	2,179,907,422	1,885,928,594

Lekë

Fondi i konoliduar		Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"		
2,048,719,031	Mbyllje më datë 31.12.2024		Çelje më datë 01.01.2024	
	Debi		Kredi	
			781,389,056	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2023
	79,878,375	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	133,684,717	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	49,015,719	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	2,329,392	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
	812,476	Jashtë përdorimit	812,476	Amortizimi nga vlera jashtë përdorimit
Totali	129,706,570		918,215,641	
918,215,641 – 129,706,570 = 788,509,071				
788,509,071 – 788,509,071 = 0				

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 781,389,056 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 133,684,717 lekë, për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 2,329,392 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" dhe amortizimin nga vlerat e nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 812,476 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimet e vitit në vlerën 78,878,375 lekë, amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 49,015,719 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" dhe vlerën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit prej 812,476 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është kontabilizuar saktë në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet"**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 107,504,593 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 150,269,751 lekë ose me një rritje në vlerën 42,765,158 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	150,269,751	107,504,593
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	160,000	315,586
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	160,000	315,586
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	64,637,195	57,309,938
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	64,637,195	57,309,938
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	85,468,056	49,869,069
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0

7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	85,468,056	49,869,069
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare	4,500	10,000
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 37,502,563 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 48,404,247 lekë ose me një rritje në vlerën 10,901,684 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	48,404,247	37,502,563
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	2,927,944	3,509,088
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	2,927,944	3,509,088
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	43,813,812	32,850,950
7110	Tarifë administrative dhe rregullatore	36,365,614	26,466,706
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	6,371,116	6,096,544
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	316,000	83,000
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	761,083	204,700
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	1,662,491	1,142,525

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 “Grante korente”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 595,462,286 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 653,008,854 lekë ose me një rritje në vlerën 57,546,568 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
72	V. GRANTE KORENTE	653,008,854	595,462,286
720	1. Grant korent i brendshëm	653,008,854	595,462,286
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	219,798,151	209,791,854
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	0	0
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficitit (ISSH e ISKSH)	86,771,490	83,677,949
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	0	0
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	12,310,387	14,234,425
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	1,225,792	11,515,519
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	0
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

4. Të ardhura të tjera:

- **Llogaria 787 “Tërheqje nga seksioni i investimeve”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 246,193,269 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 224,434,385 lekë ose me një pakësim në vlerën 21,758,884 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	VI. TË ARDHURA TË TJERA	224,434,385	246,193,269
781	Të ardhura nga investimet në ekonomi	0	0
782	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatshkurtra	0	0
783	Rimarrje shumash të parashikuara për aktive afatgjata	0	0
784	Rimarrje shumash për shpenzime të viteve të ardhshme	0	0
787	Tërheqje nga seksioni i investimeve	224,434,385	246,193,269

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 140,032,109 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 153,004,788 lekë ose me një rritje në vlerën 12,972,679 lekë.

- **Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 23,243,832 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 26,389,529 lekë ose me një rritje në vlerën 3,145,697 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Fier me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
6001	Paga, personel i përhershëm	153,004,788	140,032,109
6002	Paga personel i përkohshëm	0	0
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	26,389,529	18,511,555
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	0	4,732,277
	Totali	179,394,317	163,275,941

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 66,005,997 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 89,422,809 lekë ose me një rritje në vlerën 23,416,812 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Fier me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	89,422,809	66,005,997
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	2,877,327	6,016,717
6021	Materiale dhe shërbime speciale	22,214,438	4,009,760
6022	Shërbime nga të tretë	12,920,278	3,196,898
6023	Shpenzime transporti	15,511,215	6,763,714
6024	Shpenzime udhëtimi	956,295	300,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	6,812,410	2,084,369
6026	Shpenzime për qiramarrje	1,147,380	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,324,222	0
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	373,067	0
6029	Shpenzime të tjera operative	25,286,177	43,634,539

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Patos nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 5,215,981 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 210,126,209 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	V. TRANSFERIME KORENTE	215,342,190	207,297,769
604	1. Transferime korente të brendshme	5,215,981	0
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	5,215,981	0
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	210,126,209	207,297,769
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	207,410,497	201,926,092
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	2,715,712	5,371,677

Për vitin 2024 totali i të ardhurave në vlerë është 1,076,117,238 lekë dhe totali shpenzimeve është 797,297,690 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 278,819,548 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 278,819,548 lekë.

➤ **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➤ **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet

në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjesisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

➤ **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve.**

Nga Bashkia Patos është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkuara nga punonjësi i financës dhe titullari.

Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitorë dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Me Urdhrin nr. 23, datë 23.01.2023, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024- 2026.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 82 datë 18.12.2023, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Fier: me shkresën nr. 1303/1 date 03.01.2024.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2024-2026 miratuar respektivisht me VKB nr. 36 , datë 30/06/2023, me VKB nr. 82, datë 18/12/2023.

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2024-2026 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politikat e programit”; “Qëllimi Politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr. Program e	shënime
	Nr.	Datë	N r	Datë	Objekti	Nr.	Datë		
2024-2026	01	23.01.2023	23	23.01.2023	miratim kalendari	94	19.12.2022	17	
	03	13.02.2023	23	23.01.2023	miratim tavaneve të shpenzimeve	18/45	27.03.2023/27.07.2023	17	
	04/08/13	16.03/20.07/30.11.2023	23	23.01.2023	miratimi i tabelave të PBA	55/82	28.09.2023/18.12.2023	17	

Burimi: Drejtoria e Financës

Miratimi i tavanëve perfundimtar të buxhetit afatmesëm 2024-2026 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 45, datë 27.07.2023, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 09 datë 21.02.2023, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Patos për vitet 2024-2026”, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 81 datë 18/12/2023, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Fier me shkresën nr. 1303/1 date 03.01.2024.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2024 kanë vlerën **297,432,000** lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën **192,570,320** lekë, transfertat specifike ka vlerën **114,515,162** lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën **604,517,482** lekë dhe shpenzimet kanë vlerën **604,517,482** lekë.

Gjatë vitit 2024, Bashkia Patos me VKB nr. 07, datë 12.02.2024 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetorë 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Janë alokuar fondet e trashëguara nga viti 2023, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 224,434,385 lekë.

Janë alokuar fonde shtesë transferte specifike për arsimit parashkollor nga ministria e linjes, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës minimale në vlerën 7,079,880 lekë;

Janë alokuar fonde shtesë transferte pakushtëzuar, për efekt të mbulimit të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore si efekt rritjes së pagës në vlerën 9,731,030 lekë;

Janë alokuar fonde Buxheti shtesë Akti normativ nr.5 datë 19.12.2024. Fondi i pashperndare ne planet e buxhetit 2024 në vlerën 13,239,070 leke.

Janë alokuar fonde për përbalimin e krizës së rritjeve të cmimeve Buxheti shtesë {shkresa nr 16788/1 dt 17.12.2024 nga M.F} Fondi i pashperndare ne planet e buxhetit 2024 në vlerën 10,000,000 lekë.

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2023	Faza e I PBA 2024	Faza e II PBA 2024	Projekt Buxhet 2024
600	Paga	220,504,000	231,314,000	231,314,000	250,356,735
601	Sigurime Shoqërore	36,481,000	39,751,000	39,751,000	42,702,738
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	92,607,000	134,365,000	134,365,000	147,549,046
604.603	Mallra dhe Shërbime të Tjera		3,000,000	3,000,000	10,390,486
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	7,277,000	4,879,000	4,879,000	4,957,501
I	Shpenzime Korrente	356,869,000	413,309,000	413,309,000	455,956,506
230	Kapitale të Patrupëzuara				1,000,000
231	Kapitale të Trupëzuara	195,540,000	141,480,000	141,480,000	147,560,976
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	195,540,000	141,480,000	141,480,000	148,560,976
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale	195,540,000	141,480,000	141,480,000	148,560,976
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
I+II +III	Totali I Shpenzimeve	552,409,000	554,789,000	554,789,000	604,517,482

Gjatë vitit 2024, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Tabela e ndryshimeve buxhetore

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/datë	Vlera	Nr/datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Viti 2024	Nr. 81 datë 18.12.2023	604,517,482	Nr.07,dt. 12.02.2024	224,434,385	600+601,Paga dhe sigurime.	7,388,513	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera	7,667,620	602- 609 ShP. te tjera	0
					230+231 (Investime)	209,378,252	230+231 (Investime)	0
			Nr.32,dt. 30.04.2024	2,708,931	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera	2,708,391	602- 609 ShP. te tjera	(2,708,391)
					230+231 (Investime)		230+231 (Investime)	0
			Nr.35,dt. 30.04.2024	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera		602- 609 ShP. te tjera	
					230+231 (Investime)		230+231 (Investime)	
			Nr.36,dt. 30.04.2024	922,080	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera	922,080	602- 609 ShP. te tjera	(922,080)
					230+231, investime		230+231 (Investime)	
			Nr.48,dt. 20.06.2024	3,003,588	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	
					602- 609 ShP. te tjera		602, ShP. operative	
					230+231, investime	3,003,588	230+231 (Investime)	(3,003,588)
			Nr.49,dt. 20.06.2024	592,000	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera		602- 609 ShP. te tjera	
					230+231, investime	592,000	230+231 (Investime)	(592,000)
			Nr.56,dt. 18.07.2024	6,500,000	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera		602- 609 ShP. te tjera	
230+231, investime	6,500,000	230+231 (Investime)			(6,500,000)			
Nr.63,dt. 17.09.2024	11,346,000	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.				
		602- 609 ShP. te tjera		602- 609 ShP. te tjera				
		230+231, investime	11,346,000	230+231 (Investime)	(11,346,000)			
Nr.64,dt. 17.09.2024		2,557,006	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0		

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
					602- 609 ShP. te tjera		602- 609 ShP. te tjera	
					230+231, investime	2,557,006	230+231 (Investime)	(2,557,006)
			Nr.77,dt. 28.10.2024	150,000	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera	150,000	602- 609 ShP. te tjera	(150,000)
					230+231, investime		230+231 (Investime)	
			Nr.XX,dt. Xx.xx.202x	XXX	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602- 609 ShP. te tjera	0	602- 609 ShP. te tjera	
					230+231, investime		230+231 (Investime)	
			Buxheti shtesë	7,079,880	600+601,Paga dhe sigurime.	7,079,880	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602, ShP. operative	0	602, ShP. operative	0
					606		606	0
			Buxheti shtesë {shkresa nr 11788 dt 04.09.2024 nga M.F}	9,731,030	600+601,Paga dhe sigurime.	9,731,030	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602, ShP. operative	0	602, ShP. operative	0
					606	0	606	0
			Buxheti shtesë Akti normativ nr.5 datë 19.12.2024. Fondi i pashperndare ne planet e buxhetit 2024	13,239,070	600+601,Paga dhe sigurime.	-	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602, ShP. operative	0	602, ShP. operative	0
					606	0	606	0
			Buxheti shtesë {shkresa nr 16788/1 dt 17.12.2024 nga M.F} Fondi i pashperndare ne planet e buxhetit 2024	10,000,000	600+601,Paga dhe sigurime.	-	600+601,Paga dhe sigurime.	0
					602, ShP. operative	0	602, ShP. operative	0
					606	0	606	0

Burimi: Drejtoria e Financës.

Pasqyrë përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2024 sipas VKB përkatëse.

Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024 janë planifikuar të balancuara në vlerën 846,989 mijë lekë, sipas tabelës në vijim:

Tabela Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024

Burimi i të ardhurave	Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024			Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024			
	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 71 datë 30.11.2023	Buxheti shtesë VKB nr.07 date 12.02.2024. Buxheti shtesë VKB nr.60 date 30.08.2024; VKB nr.69 date 30.09.2024; ; si dhe akt norm.05 dt 19.12.2025; Shkresa nr 16788/1 dt 17.12.2024 nga M.F	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë 846,989 (në 000/lekë)	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 71 datë 30.11.2023	Buxheti shtesë VKB nr.07 date 12.02.2024. Buxheti shtesë VKB nr.60 date 30.08.2024; VKB nr.69 date 30.09.2024; ; si dhe akt norm.05 dt 19.12.2025; Shkresa nr 16788/1 dt 17.12.2024 nga M.F	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë 846,989(në 000/lekë)
	1	2	1+2		1	2	1+2
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	297,432,000	1,225,869	298,657,869	Art. 600 Paga	250,356,735	20,735,562	271,092,297
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2024		108,985,892	108,985,892	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	42,702,738	3,463,861	46,166,599
Total të ardhurat e veta	297,432,000	110,211,761	407,643,761	Art.602 Shpenzime operative	147,549,046	8,480,081	156,029,127
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar		70,862,058	70,862,058	Art.604 Transferime korrente të brendshme{dhe fond rezerve , kontigjence}	10,390,486		10,390,486
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike		44,586,435	44,586,435	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	4,957,501	413,328	5,370,829
Transferta e pakushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2024	192,570,320	9,731,030	202,301,350	Art. 230-231 Investime	148,560,976	209,378,252	357,939,228
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2024	114,515,162	7,079,800	121,594,962	Fondi Rezervë + gjencës (609)			
Transferta e pakushtëzuar							
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	307,085,482	132,259,323	439,344,805				
Totali i të ardhurave	604,517,482	242,471,084	846,988,566	Totali i shpenzimeve	604,517,482	242,471,084	846,988,566

Burimi: Drejtoria e Financës.

2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Tabela mbi treguesit buxhetor dhe burimin e financimit të shpenzimeve: në 000 lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Patos, për vitin 2024.											
Burimi i financimit të shpenzimit											
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Nga të ardhurat e veta	% e mbulimit nga të ardhurat e veta	Nga Granti Qeveritar				% e mbulimit nga grantet
							Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet	
1	Paga 600	287,777	248,474	86.34%	64,856	26%	106,734	71,528	5,355	0	74%
2	Sigurime shoqërore 601	49,110	41,779	85.07%	10,764	26%	17,838	12,283	894	0	74%
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	154,569	111,455	72.11%	44,112	40%	49,768	16,652	922	0	60%
4	ShP. 604 + F. Rezervë	15,457	7,094	45.90%	0	0%	0	1877	5,216	0	100%
5	Nd/Ekonom invalid 606	213,563	210,648	98.64%	1,675	1%	972	641	207,410	0	99%
6	Investime 230	6,140	169	2.75%	169	100%	0	0	0	0	0%
7	Investime 231	525,641	353,322	67.22%	130,465	37%	35,787	13,349	0	173,722	63%
	Totali	1,252,257	972,941	78%	252,041	26%	211,099	116,330	219,797	173,722	74%

Burimi: Drejtoria e Financës

Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2024

Në 000/lekë

Kodi i detyrimit të prapamb.	Emerimi i detyrimit të prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 31.12.2023	Shtesa detyrim i prapambetur gjate vitit 2024 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2024 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	Total Detyrim i prapambetur 31.12.2024
4864100	Detyrime per vend. gjyqesore		0	0	0
4864200	D.P.per sherbime				0
4864300	D.P.per mirembajtje				0
4864400	D.P.per investime				0
4864400	D.P.per investime nga Ministrite e Linjes 11 dhe 06	0	0	0	0
4865600	D.P.per mallra				0
4864900	D.P.te tjera				0
	Totali	0	0	0	00

Evidencat mbi realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore) për periudhën objekt auditimi, konfirmuar nga Dega e Thesarit në Rreth, pasqyra:

Në 000/lekë

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
a	b	7	8	9
I	Te ardhura nga Tatimet	0	40	
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	0	40	
II	Te ardhura nga Taksat	190822	155414	81.4
2	Taksa mbi B. Vogel	0	0	
3	Taksa e Pasurisë, ndertese	21850	14737	67.4
4	Taksa mbi token Bujqesore	21420	10503	49
5	Takse Trualli	38500	39397	102

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024		
		Plan	Fakt	%
a	b	7	8	9
6	Takse mbi rregj e Automjete	17000	18381	108
7	Takse e Rentës minerare	75434	57298	76
8	Tatimi mbi te ardhurat personale	6000	11093	184
9	Taksa e ndik te nd mbiinfrast	7000	2267	32.4
10	Takse Tregu	1290	487	37.7
11	Takse Tabele	650	472	72.6
12	Takse Parkimi	921	570	62
13	Takse per hapësira publike	250	209	83
14	Takse reklame	507	0	0
III	Te ardhura nga Tarifat	99900	124409	125
15	Tarife Pastrimi	42031	35251	83.8
16	Tarife leje transport.	3179	1114	35
17	Tarife vendore per ndotje mjedisi	44035	76437	173
18	Tarife per Sherbim Komunitar	5026	1617	32
19	Tarifa per sherbime te tjera administrative	1149	2607	226
20	Tarife ndriçimi rrugor	1800	2396	133
21	Tarife vendore gjelberimi	1800	2398	133
22	Te ardhura te tjera	0	1816	
23	Tarife per mirembajtje vaditje kullim	880	773	87.8
IV	Te ardhura te tjera	6710	6808	101
24	Shitje Pase&privatiz banese	400	0	0
25	Qera kullote	1300	1082	83
26	Gjoha.	500	761	152
27	Qera ndertese	1710	1846	108
28	Dhurata, sponsoi & Garanci.	0	1225	
29	Te ardhura nga kopesht+cerdhe	2800	1894	67
	GJITHSEJ (I+II+III+ IV)	297432	286671	96

Niveli i detyrimeve të papaguara në fund të periudhave 2024, paraqitet si vijon, pasqyra:

Emërtimi	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2024 Kontabilizuar	
	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet	80	8,479,416	29	3,350,348	51	5,129,068
Nga abonentet familjarë	5,414	86,425,784	5,414	18,795,638	5,414	105,221,422
Nga taksa e tokës bujqësore	4042	65,361,403	4042	10,916,872	4042	76,278,275
Nga taksa infrast (ALUIZNI)	1158	39,904,291	0	0	1153	38,502,631
Nga kontratat	67	1,894,120	67	400,134	67	2,294,254
Gjoha te ndryshme	0	0	0	0	0	0
Nga kamat vonesa nëse ka	0	0	0	0	0	0
Të tjera	0	0	0	0	0	0
TOTALI		202,065,014		33,462,992		227,425,650

Pavarësisht se Bashkia ka respektuar afatet ligjore dhe kalendarin buxhetor për miratimin e buxhetit vjetor dhe ka ndjekur procedurat e kërkuara përmes Grupit të Menaxhimit Strategjik, analiza e performancës gjatë vitit 2024 tregon se ka ende sfida që duhet të adresohen në mënyrë strategjike. Rritja e konsiderueshme e buxhetit nga fillestari prej 604 milionë lekësh në mbi 846 milionë, si pasojë e fondeve shtesë dhe rritjes së pagave, kërkon një menaxhim më të kujdesshëm dhe një koordinim më të mirë ndërinstytucional.

Të ardhurat janë realizuar në total, por struktura e tyre tregon për pasaktësi në planifikim dhe mospërputhje në performancën e disa zërave. Ndërsa janë evidentuar tejkalime në disa tarifa dhe

tatime si ai mbi të ardhurat personale, tarifa për ndotjen e mjedisit dhe tarifat administrative, ka gjithashtu mospërmbushje të dukshme në disa burime të rëndësishme të të ardhurave vendore, përfshirë taksën për ndikim në infrastrukturë, taksën për treg dhe taksën për reklama. Kjo tregon për nevojën që bashkia të rishikojë metodat e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave, duke u mbështetur në analizën historike dhe trendet faktike, si dhe të përforcojë instrumentet e mbledhjes së të ardhurave, sidomos në zërat me performancë të ulët.

Në anën tjetër, realizimi i shpenzimeve, i cili është vetëm 78% i planit vjetor, ngre shqetësime veçanërisht në lidhje me zbatimin e shpenzimeve kapitale. Niveli shumë i ulët i realizimit të investimeve, me një përqindje prej vetëm 2.75% për zërin 230, tregon për vështirësi në zbatimin e projekteve publike. Nga 45 projektet e miratuara, një pjesë e konsiderueshme ka realizim nën 50 %, ndërsa një numër i madh rezulton të mos jetë zbatuar fare. Këto të dhëna sinjalizojnë për një boshllëk në kapacitetet administrative dhe teknike të bashkisë, përfshirë hartimin e dokumentacionit teknik, zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe monitorimin e ecurisë së projekteve.

Megjithëse bashkia raporton se nuk ka detyrime të prapambetura në fund të vitit dhe ka realizuar rakordimin me Thesarin sipas kërkesave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, rreziku më i madh fiskal qëndron pikërisht në mosrealizimin e projekteve investuese. Ky fakt jo vetëm që ndikon negativisht në realizimin e objektivave zhvillimore, por rrezikon të cenojë besueshmërinë e bashkisë ndaj qytetarëve dhe donatorëve.

Në këtë kontekst, rekomandohet që Bashkia të ndërmarrë një rishikim të plotë të proceseve të menaxhimit të investimeve, duke përfshirë ngritjen e një grupi pune të dedikuar për përgatitjen teknike të projekteve, forcimin e monitorimit të brendshëm financiar dhe përmirësimin e bashkëpunimit me strukturat e qeverisjes qendrore. Gjithashtu, transparencja në raportim, parashikimi realist i të ardhurave dhe planifikimi i kujdesshëm i shpenzimeve mbeten thelbësore për një menaxhim të qëndrueshëm dhe efektiv të buxhetit.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F. D. Kryetar i Bashkisë Patos në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, znj. M.Sh. Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare dhe z. Ç. R. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

2.3. Të tjera çështje përgjatë auditimit.

2.3.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

- Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.
- Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.
- Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Bashkia Patos me shkresën nr. 6746 prot., datë 17.12.2024, ka raportuar pranë KLSH-së ecurinë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar kështu edhe afatin 20 ditor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Patos me shkresën nr. 6749 prot., datë 13.06.2024, ka raportuar pranë KLSH-së ecurinë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Patos administruar në KLSH me nr. 30/11 prot., datë 04.06.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 67/44 prot., datë 06.06.2024, janë rekomanduar gjithsej:

- 19** masa organizative;
- 5** masa për shpërblim dëmi në vlerën **11,772,884 lekë**;
- 3** masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën **205,519,291 lekë**;
- 8** masa disiplinore;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	19	19	0
Masa për shpërblim dëmi	5 11,772,884	5	0
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	3 205,519,291	3	0
Masa disiplinore	8	8	0
Totali	35	35	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Patos:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	19	3	0	15	1
Masa për shpërblim dëmi	5 11,772,884	0	0	5	0
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	3 205,519,291	0	0	1	2
Masa disiplinore	8	8	0	0	0
Totali	35	11	0	21	3
Totali në %	100%	31.42%	0	60%	8.58

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrimit të Riskut (iii) si dhe të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën organizative, duke paraqitur në mënyrë të plotë e të saktë detyrat specifike të punonjësve, duke bërë edhe përditësimet të vijueshme në rastet e ndryshimit të strukturës, (iv) të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi vjetore për ngritjen profesionale të stafit bazuar në nevojat e njësive; për vendosjen e një sistemi komunikimi sa më efektiv që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 2550 prot., datë 27.09.2023, z. F.D. Kryetar i Bashkisë Patos ka miratuar Strategjinë e Riskut me një afat tre vjeçar. Gjithashtu nga Grupi i Menaxhimit Strategjik është hartuar Regjistri i Riskut me shkresën nr. 3444 prot., datë 12.09.2024. Struktura organizative e institucionit ka pësuar disa përditësime konkretisht ndryshimi i fundit është kryer me shkresën 3383 prot., datë 06.09.2024, përditësim i cili është aplikuar edhe në Rregulloren e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit të miratuar me Vendimin nr. 25, datë 26.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë. Plani vjetor i trajnimeve është miratuar Drejtoria e Burimeve Njerëzore me shkresën nr. 170 prot., datë 19.01.2024.

Rekomandimi është zbatuar

2.1. Rekomandimi: Drejtuesi i Njesisë së auditimit të brendshëm dhe audituesit, të ndjekin me korrektësi çdo fazë të misionit auditues, duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse; pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjektin e audituar, t'i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht në Njësinë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit;

- Të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t'ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 346/1 prot., datë 02.02.2024, znj. E.H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm ka hartuar Programin e Angazhimit të Auditimit me objekt "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NjAB". Me shkresën nr. 4180 prot., datë 18.11.2024, Përgjegjësi i NjAB ka dërguar pranë Drejtorive të Institucionit hapat e marra prej tyre për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga NjAB. Me shkresën nr. 4180/4 prot., datë 17.12.2024, Përgjegjësi i NjAB ka dërguar informacion pranë Kryetarit të Bashkisë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Me shkresën nr. 897 prot., datë 21.03.2025, Kryetari i Bashkisë Patos ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Raportin vjetor mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të NjAB.

Rekomandimi është zbatuar

3.1. Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masa të nxjerrë në shitje aksionet që zotëron në shoqërinë "Shoqatës Sportive Albpetro", sha me qëllim menaxhimin me ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit, duke i përdorur ato në investime me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve të Bashkisë Patos.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 133, datë 15.07.2024, Kryetari i Bashkisë Patos ka ngritur një grup pune me përbërje nga 6 (gjashtë) punonjës të institucionit, për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe ndjekjen e procedurave të themelimit të Shoqërisë Aksionare të Klubit "K. F. Albpetro" Sh.a.

Rekomandimi është në proces zbatimi

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Patos, të marrin masa për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke bërë një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore, kjo duke u mbështetur në burimet e krijimit të të ardhurave dhe arkëtimin e borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga familjet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi mbi planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2024 paraqitet në vlerën 297,432,000 lekë realizuar në vlerën 286,671,281 lekë në masën 96% me një diferencë mosrealizimi në vlerën 10,760,719 lekë. Edhe për vitin 2024 për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore gjendje 31.12.2023, në vlerën **207,517 mijë lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore. Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,039,680 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 35,545,733 lekë me një rritje në vlerën 21,506,053 lekë. Me shkresën nr. 3590/2 prot., datë 03.12.2024, Drejtori i Drejtorisë së Financës ka paraqitur kërkesën për informacion lidhur me situatën debitorë nga takasat dhe tarifatat vendore për vitin 2024, drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore. Në lidhje me këtë situatë me shkresën nr. 766 prot., datë 07.03.2025, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit ka paraqitur situatën debitorë progresive deri më datë 31.12.2024, për kategoritë “Biznes i madh dhe i vogël” në vlerën 5,129,068 lekë dhe “Subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarburet dhe derivatet e tyre” në vlerën 5,350,000 lekë. Gjendja debitorë progresive nga taksat dhe tarifatat vendore më datë 31.12.2024, sipas DZHETMT-së është në vlerën 232,775,650 lekë. Nga DZHETMT-ja nuk është paraqitur informacioni i plotë për kontabilizimin e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në Drejtorinë e Financës. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë të përfshirë debitorët kontratat për dhënie me qira të tokave bujqësore, abonentët familjarë, taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

6.1. Rekomandimi: Drejtorisë së Shërbimeve dhe Hartimit të Projekteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave Bashkia Patos, të marrë masa për njoftimin e subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të ç’ngurtësuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës. Për rastet e refuzimit ose mos kërkesës së subjekteve të kërkohet bashkëpunim me Drejtorinë e Thesarit për riaktivizimin e këtyre fondeve në interes të bashkisë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 1305 prot., datë 15.05.2024, Drejtori i Drejtorisë së Financës ka dërguar pranë Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit kërkesën për informacion mbi Planin e Zbatimit e Rekomandimeve të KLSH-së. Në këtë shkresë citohet se, Drejtorisë të PUZHT-së për fillimin e procedurave për zbatimin e rekomandimeve për 29 objekte investimesh të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimeve. Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 konstatohet se, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Patos në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 65,465,994 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masë 5%. Kjo problematikë konstatohet edhe për vitin 2024, konkretisht për 33 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Patos janë ngurtësuar fonde në vlerën 38,426,624 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Fier, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të

kontratës.

Rekomandimi është në proces zbatimi

7.1. Rekomandimi: Bashkia Patos (AK dhe Njësia e Prokurimit), të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të vendosur specifikimet teknike, “Treguesit kryesor teknik sipas pasaportës teknike”, duke përcaktuar nevojat reale për punë, shërbime dhe mallra.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t’u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt “Përputhshmërinë”.

Rekomandimi është në proces zbatimi

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve të përfshirë në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim argumentimin e kritereve të vendosura për çdo procedurë të jetë në përputhje me tipologjinë e procedurës dhe që gjatë vlerësimit të ofertave të mbajnë në konsideratë garantimin e Autoritetit kontraktor në realizimin në afat dhe me cilësi të kontratës.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t’u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt “Përputhshmërinë”.

Rekomandimi është në proces zbatimi

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos dhe Strukturat Përgjegjëse të marrin masa për mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, duke mos lejuar copëzim të fondeve si dhe dokumentimin e të gjithë hapave të procedurës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t’u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt “Përputhshmërinë”.

Rekomandimi është në proces zbatimi

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të ngarkojë Zyrën e Protokoll-Arkivës, për inventarizim dhe arkivim e dosjeve të investimet për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit si dhe në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t’u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt “Përputhshmërinë”.

Rekomandimi është në proces zbatimi

11.1. Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masa që të pajisë me **Oponencë Teknike** çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Përputhshmërinë".

Rekomandimi është në proces zbatimi

12.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Patos për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, **brenda 30 ditëve** nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Përputhshmërinë".

Rekomandimi është në proces zbatimi

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit Bashkia Patos, të marrë masa për verifikuar në çdo rast respektimin e distancave urbane nga objektet e tjera, sipas përcaktimeve ligjore, të kërkojnë përmasimin e parcelave në zhvillim dhe evidentimin e distancave urbane nga rrugët, parcelat kufitare dhe objektet e tjera, që në dokumentin e rievimit topografik, me qëllim marrjen e sigurisë së lartë se objekti në zhvillim i respekton të gjithë kondicionet urbane.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Përputhshmërinë".

Rekomandimi është në proces zbatimi

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit, Bashkia Patos të marrë të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Përputhshmërinë".

Rekomandimi është në proces zbatimi

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit, Bashkia Patos të marrë të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Përputhshmërinë".

Rekomandimi është në proces zbatimi

16.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit, Bashkia Patos të marrë të gjitha masat për të rritur dhe përmirësuar bashkëpunimin ndër-strukturor, me qëllim rritjen e cilësisë dhe shpeshësisë së

kontrolleve dhe inspektimeve në territorin e Bashkisë Patos, me qëllim evidentimin e kundërvajtjeve dhe reduktimin e shmangieve nga projektet e miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Përputhshmërinë".

Rekomandimi është në proces zbatimi

17.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin për plotësimin e strukturës së IMT me specialist të fushës në zbatim të kuadrit ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Përgjatë vitit 2024 janë kryer dy emëtime të reja në strukturën e IMTV-së konkretisht: z. A. G. me detyrë Kryeinspektor me profesion inxhinier mjedisi me Vendimin nr. 117, datë 21.06.2024, dhe z. A. N. me profesion Jurist pranë IMTV-së me Vendimin nr. 223, datë 01.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos.

Rekomandimi është zbatuar

18.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave janë mbajtur procesverbale prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të zbatojë vendimet e prishjes së objekteve duke ndjekur më tej edhe procedurat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Verifikimi i këtij rekomandimi mbetet për t'u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillohet nga KLSH me objekt "Përputhshmërinë".

Rekomandimi është në proces zbatimi

A.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

19.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa Organizative

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

11.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit, të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

32.1/7.1. Rekomandim (rikërkuar): Bashkia Patos, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

32.2/8.1. Rekomandim (rikërkuar): Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimt të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011

“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë

B. Masa Shpërblim Dëmi

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 96,532 lekë pa TVSh nga BOE “MIG Shpk & “L.K.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 851/15 prot datë 03.08.2021, me objekt “Sistemimi i hapësirave, Lagjja “29 Marsi”, Blloku Zjarrfikësja”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 481,563 lekë pa TVSh nga OE “C.R.2” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. Masa për uljen e borxhit tatimor

32.1/2.1 Rekomandim (rikërkuar): Bashkia Patos të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë.

32.1/2.3 Rekomandim (rikërkuar): Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitore prej 44,507,884 lekë

3.2. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të vazhdojë korrespondencën zyrtare me ASHK Fier në lidhje me situatën debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2022.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhura Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në total në vlerën 1,963,641 lekë duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, nga Bashkia Patos nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **7,574,268 pa TVSh** nga OE “2.” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020, me objekt “Rikonstruksioni i magjistratit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)” Bashkia Patos.

Deri më 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 1728/1 prot., datë 03.12.2024, z. F.D. Kryetar i Bashkisë Patos i ka ridërguar njoftim për shlyerje detyrimi drejtuar OE “2.” Shpk në vlerën 9,089,122 lekë. Ky

rekomandim ka mbetur në fazën e dërgimit të njoftimit për shlyerje të detyrimi.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **829,438 pa TVSh** nga OE “Sh.” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1784/18 prot., datë 05.12.2022, me objekt “Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës” Bashkia Patos. Vlera prej **332,430 lekë pa TVSH**, duhet t’i mbahet sipërmarrësit të punimeve nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos në situacionin përfundimtar për volume pune të likuiduara më tepër në situacionin nr. 1, datë 22.12.2022 për zërat e punimeve (Zëri 7 (An). Prishje suvatim i jashtëm t=2-3 cm dhe Zëri 8(An). Prishje suvatim i brendshëm t=2-3 cm).

Deri më 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 3041/47 prot., datë 18.11.2024, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Monitorimit të Shërbimeve ka paraqitur situacionin përfundimtar të punimeve për objektin “Rikonstruksion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim palestres”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë. Edhe pse nga OE “Sh.” Shpk është lëshuar situacioni përfundimtar i punimeve, ky rekomandimin mbetet për t’u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillojë KLSH me objekt “Përputhshmërie”, me qëllim krahasimin e situacionit me faktin në terren.

Rekomandimi është në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **877,040 pa TVSh** nga OE “N.” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 2085/22 prot., datë 20.12.2022, me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Bashkia Patos.

Deri më 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 1729 prot., datë 04.07.2024, Kryetari i Bashkisë i ka dërguar njoftim për shlyerje detyrimi drejtuar OE “N.” Shpk. Me shkresën nr. 1729/1 prot., datë 03.12.2024, është ridërguar njoftimi për shlyerje detyrimi OE “N.” Shpk.

Rekomandimi është në proces zbatimi

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Patos t’i kërkojnë menjëherë sipërmarrësit të punimeve “S.” SHPK të hartojnë situacionin përfundimtar të punimeve (pasi situacioni përfundimtar i paraqitur nga sipërmarrësi në bashki, nuk pasqyron volumet faktike sipas preventivit të ripunuar dhe tabelës së rakordimit të punimeve që shtohen dhe punimeve që pakësohen) duke rakorduar volumet për zërat e punimeve që janë likuiduar tepër në situacionin nr. 1, datë 07.04.2023 dhe në situacionin nr. 2, datë 19.01.2023, dhe, duke zbritur vlerën **1,921,946 lekë pa TVSH**, vlerë e cila është likuiduar për volume tepër, si pasojë e mos rakordimeve të volumeve të projekt preventivit me volumet sipas faktit nga matjet në objekt.

Në vijim, Titullari i Bashkisë Patos të ngrëjë grupin e punës për marrjen në dorëzim të investimit dhe, të fillojë procedura e marrjes së përkohshme në dorëzim të objektit.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga “S.” Shpk është lëshuar situacioni përfundimtar i punimeve por ky rekomandimin mbetet për t’u verifikuar në auditimin e ardhshëm që do të zhvillojë KLSH me objekt “Përputhshmërie”, me qëllim krahasimin e situacionit me faktin në terren.

Rekomandimi është në proces zbatimi

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **237,762 pa TVSh** nga OE “I.” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, parashikuar në kontratën me nr. 1861/16 prot., datë 28.09.2022, me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra të pa favorizuara” Bashkia Patos. Kryetari i Bashkisë Patos në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve shoqërinë “D.” SHPK, t’i kërkojnë sipërmarrësit të punimeve shoqërisë “I.” SHPK, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në banesën e z. K.G., Zharrëz.

Deri më 30.09.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 1727 prot., datë 04.07.2024, Kryetari i Bashkisë i ka dërguar njoftim për shlyerje detyrimi drejtuar OE “I.” Shpk. Me shkresën nr. 1727/1 prot., datë 03.12.2024, është ridërguar njoftimi për shlyerje detyrimi OE “I.” Shpk.

Rekomandimi është në proces zbatimi

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **160,265 mijë lekë** si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “Mospagimi taksave dhe tatimeve”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Patos u ka dërguar subjekteve njoftim detyrimi faturë për arkëtim 4544 prot., datë 31.12.2024. Ky model shkresë është dërguar të gjithë subjekteve debitorë të kategorisë biznes i madh dhe biznes i vogël. Për subjektet që janë debitorë është dërguar shkresa nr. 4526 prot., datë 30.12.2024, si model bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive. Theksojmë se ky rekomandim ka mbetur në këtë fazë.

Rekomandimi është në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa duke bashkëpunuar me ASHK me qëllim arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë për **1158 persona** me vlerë **39,904,291 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, nga Bashkia Patos nuk është marrë asnjë

masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

3.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjektet:

- “**A.P.**” ShPK, për shumën e mbetur **600,000 lekë**
- “**H**” ShPK, për shumën e mbetur **850,000 lekë**
- “**E**” ShPK, për shumën **1,000,000 lekë**
- “**E**” ShPK, për shumën **1,000,000 lekë**
- “**G**” ShPK, për shumën **1,900,000 lekë**

Brenda datës 30.9.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se, nga Bashkia Patos nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar

D. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Patos t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, sipas gremës “c” e nenit 58, për 3 (tre) punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. J.Sh. me detyrë Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt:

- Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga “Dhori Tanaka” me fond limit 13,462 mijë lekë.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4119/2 prot., datë 20.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

2. Z. M.N. me detyrë specialist në Njësinë e Prokurimit, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt:

- Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga Dhori Tanaka” me fond limit 13,462 mijë lekë.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4161/2 prot., datë 20.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës

disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

3. Znj. B.M. me detyrë ing. në Drejtorinë e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit KVO-së, për shkeljet e konstatuara në
- Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga Dhori Tanaka” me fond limit 13,462 mijë lekë.

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4120/2 prot., datë 20.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

b- “Vërejtje”, sipas gurmës “a” të nenit 58 për 5 (pesë) punonjës

1. Z. L.C., në cilësinë e drejtorit të DPKKZHU;

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4119/2 prot., datë 19.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

2. Z. D.Xh., në cilësinë spec. i aseteve publike të DPKKZHU;

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4117/2 prot., datë 19.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

3. Znj. E.B., në cilësinë e specialist-jurist, Sektori Juridik;

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4112/3 prot., datë 20.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

4. Znj. N.H., në cilësinë e përgjegjës Sektori Juridik;

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4115/2 prot., datë 20.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

5. Znj. A.K., në cilësinë e spec. pranë DPKKZHU;

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 271, datë 11.11.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është ngritur komisioni disiplinor për nëpunësin civil, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr. 4116/2 prot., datë 19.11.2024, komisioni disiplinor ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar

Për shkeljet e konstatuara në miratimin e lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të tyre respektivisht:

a. Leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive, me adresë në Verbas, Bashkia Patos, me zhvillues z. F.H., për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023.

b. Leje ndërtimi për magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh, me adresë në Zharrëz, Bashkia Patos, me subjekt zhvillues z. F.K., për të cilën është marrë Vendimi Nr. 492/3 Prot; datë 24.03.2023;

c. Certifikatë përdorimit për dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, me adresë në Verbas, Bashkia Patos, zhvilluesi D. ShPK, për të cilën është marrë vendimi nr. 377/3 prot; datë 18.04.2023.

2.3.2. Shqyrtimi i Ankesës së z. H.H.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të kërkesave të përcaktuara në nenet 15 dhe 26 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në lidhje me “kërkesën për verifikim ...” e z. H.H. me nr. 1394 prot., datë 20.11.2024. ka kërkuar informacion nga Bashkia Patos me shkresën nr. 1394/3 Prot., datë 16.01.2025

Z. H. shpreh shqetësimin se gjatë punimeve që janë kryer për shtrimin e rrugës Dukas-Kuqar-Rusinjë, firma e cila është marrë me punimet, ka bllokuar një kanal ekzistues dhe si pasojë gjatë reshjeve, banesa e qytetarit përmytet.

Në përgjigje ndaj qytetarit dhe KLSH-së Bashkia Patos, me nr. Prot. 194/1, datë 30.01.2025 thekson që “...segmenti rrugor i quajtur “Unaza Rurale”, që përfshin fshatrat Dukas-Manekaj-Kuqar- Rusinjë, investim i kryer nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Janë kryer punime si: përmirësim i shtresave rrugore asfaltike, ndërtim i urave të kalimit, ndërtim mure mbajtës dhe ndërtim i kanaleve kullues. Referuar ankesës së qytetarit H.H., i ndodhur në fshatin Kuqar, specialistët e Bashkisë Patos kanë kryer verifikimin dhe kanë konstatuar se në këtë segment është ndërtuar një kanal kullues i ujërave të shiut dhe shkarkimi i tyre të bëhet në gjendje të lirë në parcelën bujqësore në afërsit të banesës. Duke patur parasysh terrenin kondrinor në të cilën është e pozicionuar banesa e qytetarit H.H. nuk ekziston mundësiar e përmytjes dhe kanali i cili bën disiplinimin e ujërave të shiut është i zhbllokuar...”.

Qytetari z. H.H., dërgon pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, ankesën e dytë me objekt të njëjtë, protokolluar pranë KLSH me nr. 358 Prot., datë 21.03.2025, në të cilën shpreh po të njëjtën ankesë në lidhje me kanalin pranë shtëpisë së tij, i cili sipas qytetarit nuk kryen funksion, shtëpia e tij vazhdon të përmytet dhe punimet janë jo cilësore.

Grupi i auditimit me përbërje z. E.K. dhe z. M.H., në prani të znj. B.M., Drejtor i Urbanistikës pranë Bashkisë Patos dhe z. H.H. (ankimues), kryen verifikimet në terren për të kuptuar më qartë problematikën e qytetarit në fjalë.

Nga verifikimi në terren grupi i auditimit konstatoi:

- Nga ana e Bashkisë Patos, nuk u vu në dispozicion projekti i segmentit rrugor i quajtur “Unaza Rurale”, për të kuptuar nëse ka pasur devijime nga firma kontraktuale në zbatimin e punimeve, pasi në segmente të ndryshme rrugore, kishte ndërtime të kanaleve kulluese.

- Pranë shtëpisë së qytetarit është ndërtuar një kanal kullues, nga ana e Bashkisë Patos dhe jo nga firma kontraktuese (pasi kjo e fundit ka kryer kolaudimet dhe rruga është përfunduar dhe e dorëzuar).
- Kanali kullues i ndërtuar nuk është në proporcion me karakteristikat që duhet të ketë një kanal kullimi, ose të jetë i ngjashëm me kanalet kulluese të ndërtuara përgjatë rrugës në segmente të ndryshme.

Foto ilustruese





IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Plani vjetor i punësimit rezulton të jetë hartuar dhe miratuar pa një studim të mirëfilltë nga secila strukturë e bashkisë mbi nevojat dhe kriteret e tyre, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 3, neni 9 pika 1.1/c.

Bashkia Patos ka hartuar "Planin Vjetor të Pranimimit në Shërbimin Civil për vitin 2024" pa përfshirë edhe nevojat e njësisë për ato pozicione marrëdhëniet e punës të të cilave me punonjësit rregullohen me Kodin e Punës, ka hartuar dhe miratuar strukturën organizative pa shoqëruar me një relacion të detajuar, mbi nevojat për punonjësit provizorë në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2015 "Për nëpunësin civil" neni 18; VKM nr. 108/2014 pika 11,13; si dhe udhëzimeve të DAP. Bashkia Patos deri në 31.12.2024 ka publikuar vendet vakante në faqen zyrtare të saj si dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA, duke anashkaluar standat e bashkisë, në moszbatim të VKM nr. 108/2014 "Për Planin vjetor të Pranimimit në Shërbimin Civil" pika 13; VKM nr. 243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar Kreu II pika 6, 10/b.

Nga Bashkia Patos, nga të gjitha njësitë e strukturës nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm i unifikuar, periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", "Manualit për Menaxhimin

financiar dhe kontrollin”Kapitulli III pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13 të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,039,680 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 35,545,733 lekë me një rritje në vlerën 21,506,053 lekë. Me shkresën nr. 3590/2 prot., datë 03.12.2024, Drejtori i Drejtorisë së Financës ka paraqitur kërkesën për informacion lidhur me situatën debitore nga taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2024, drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore. Në vijim të korrespondencës të sipërcituar me shkresën nr. 766 prot., datë 07.03.2025, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit ka paraqitur situatën debitore progresive deri më datë 31.12.2024, për kategoritë “Biznes i madh dhe i vogël” në vlerën 5,129,068 lekë dhe “Subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarburet dhe derivatet e tyre” në vlerën 5,350,000 lekë. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, gjendja debitore progresive nga taksat dhe tarifatat vendore më datë 31.12.2024, sipas DZHETMT-së është në vlerën 232,775,650 lekë. Nga DZHETMT-ja nuk është paraqitur informacioni i plotë për kontabilizimin e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në Drejtorinë e Financës. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë të përfshirë debitorët kontratat për dhënie me qira të tokave bujqësore, abonentët familjarë, taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.

Si dhe nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 31.03.2026

3. Gjetje nga auditimi: Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 3,146,559 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është është përllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 1,074,287 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,146,559 lekë. Duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika

30, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Bashkia Patos, Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2025 të bëjë sistemimin e vlerës 1,074,287 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “*Toka, troje, terrene*” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*”, u konstatua se kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 13,981,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjetllës Kanalizime Patos me Nipt J63208406B është 14,530,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier me Nipt M23315402G. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Patos sipas Marrëveshjes “*Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier*” me nr. 1808 prot., datë 26.07.2022, është 549,000 lekë ose në masën 5.49% ($5.49\% * 10,000,000 \text{ lekë} / 100 = 549,000 \text{ lekë}$). Ndërkohë që llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 14,530,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale*” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24 të Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2026

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 “*Për aktive afatgjata materiale*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 782,365,081 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 304,182,116 dhe pakësime në vlerën 121,311,736 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 965,235,461 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie është përfshirë Kontrata e Punimeve me nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe OE “2.” Shpk me objekt “*Rikonstruksion i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetllësit Qytetit Patos Loti 1 (Rrjeti shpërndarës)*” dhe Kontrata e Mbikëqyrjes së Punimeve me nr. 2506/12 prot., datë 31.03.2020, e lidhur ndërmjet Bashkisë Patos (AK) dhe Shoqërisë “GCE” Shpk. Më datën 20.07.2022, është mbajtur Akt-kolaudimi i punimeve dhe më datë 29.07.2022, Çertifikata e Marrjes së Përkohshme në Dorëzim të Punimeve. Në gjendjen e llogarisë 231 “*Për aktive afatgjata materiale*”, vlera për kontratat e sipërpërmendura është kontabilizuar vlera 537,875,693 lekë dhe për pasojë duhej të kontabilizoheshin në llogarinë llogarinë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24 të Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 537,875,693 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të investimeve të përfunduara dhe të marra në dorëzim

në llogarinë 231 “Për aktive afatgjata materiale”, duke i kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

Deri më datë 31.03.2026

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Patos në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 65,465,994 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 33 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Patos janë ngurtësuar fonde në vlerën 38,426,624 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Fier, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 38,426,624 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për analizimin e përdorimit për interes publik të fondeve që ju ka mbaruar periudha e garancisë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 31.12.2025

7. Gjetje nga auditimi: Buxheti i vitit 2024 është planifikuar dhe miratuar në përputhje me kalendarin e përcaktuar në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Buxheti fillestar është ndryshuar disa herë gjatë vitit për shkak të Fondit të trashëguar nga viti i kaluar, Transfertave specifike për rritje pagash, Akteve normative të qeverisë dhe Rritjes së çmimeve dhe alokimeve për emergjenca. Janë bërë ndryshime të konsiderueshme, që i çojnë shpenzimet nga 604 mln lekë në 846 mln lekë (+40% rritje). Totali i të ardhurave për vitin 2024 planifikohet në ~847 mln lekë, përfshirë fondet e trashëguara. Realizimi është në masën 96% e planit – një tregues pozitiv në përgjithësi. Disa taksa kanë realizim të dobët si : Taksa ndikimit në infrastrukturë – 32.4%, Taksa për treg – 37.7%, Taksa për reklama – 0%. Ndërkohë, disa tarifa e tejkalojnë planin si: Tarifa për ndotje mjedisi – 173%, Tarifa për shërbime administrative – 226%, Tatimi mbi të ardhurat personale – 184% Gjithashtu ka mospërputhje të konsiderueshme në planifikim vs realizim, çka nënkupton dobësi në analizën fiskale. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24 të Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masat për përmirësimin e procesit të vlerësimit të realizueshmërisë së të ardhurave, Të kërkohen shpjegime për tejkalimet dhe mungesat e mëdha si dhe të forcohet bashkëpunimi me strukturat tatimore dhe monitorimi i zbatimit të taksave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve është në masën 78%. Shpenzimet korrente kanë realizim relativisht të mirë, por ato kapitale (investimet) kanë mjaft problematika. Shpenzimet kapitale (zëri 230) kanë realizim vetëm 2.75% – kjo tregon që projektet janë të papërgatitura mirë, kanë probleme në prokurime, ka moszbatim të planeve të investimit ose

mungesë kapacitetesh teknike për zbatim. Gjithashtu Janë planifikuar mbi 40 projekte investimesh ku disa projekte kanë realizim të plotë 100%, por një numër i madh ka realizim të ulët ose zero (0–26%). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24 të Raportit të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masat të verifikojë lista e investimeve cilat janë kontraktuar, cilat jo, të krahasohet progresi fizik me pagesat dhe dokumentacionin mbështetës si dhe të analizohen vonesat: mungesë fonde, procedura të zgjata, mungesë operatorësh, etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Patos administruar në KLSH me nr. 30/11 prot., datë 04.06.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 67/44 prot., datë 06.06.2024, ku janë lënë për zbatim **19 masa** organizative, **5 masa** për shpërblim dëmi në vlerën **11,772,884 lekë**; **3 masa** për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën **205,519,291 lekë** dhe **8 masa** disiplinore.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 19 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë zbatuar plotësisht, 15 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë nuk është zbatuar.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa në vlerën 11,772,884 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 5 masa janë në proces zbatimi.

c. Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash janë rekomanduar 3 masa në vlerën 205,519,291 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është në proces zbatimi dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

d. Masa disiplinore janë rekomanduar 8 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 8 masa janë zbatuar plotësisht. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 54 të Projekt Raportit të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e rekomandimeve në proces zbatimi si më poshtë:

a. Për 15 masa organizative në proces zbatimi dhe 1 masë e pa zbatuar: nr. 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 13.1, 14.1, 15.1, 16.1, 18.1 dhe 19.1.

b. Për 5 masa shpërblim dëmi në proces zbatimi: nr. 1.1, 2.1, 3.1, 4.1 dhe 5.1.

c. Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash, në proces zbatimi dhe 2 masa të pa zbatuara: nr. 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i ankesës së z. H.H. si dhe nga verifikimi në terren grupi i auditimit konstatoi që pranë shtëpisë së qytetarit është ndërtuar një kanal kullues, nga ana e Bashkisë Patos dhe jo nga firma kontraktuese (pasi kjo e fundit ka kryer kolaudimet dhe rruga është përfunduar dhe e dorëzuar) si dhe Kanali kullues i ndërtuar nuk është në proporcion me karakteristikat që duhet të ketë një kanal kullimi, ose të jetë i ngjashëm me kanalet kulluese të

ndërtuara përgjatë rrugës në segmente të ndryshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 57 të Raportit të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, duhet të marrë masa për të analizuar situatën dhe për të vepruar në përputhje me procedurat ligjore. Gjithashtu, duhet të ndërmarrë hapa konkretë për zgjidhjen e çështjes në fjalë, duke ruajtur gjithmonë prioritetin e interesit qytetar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT